



Fondi për të Drejtën Humanitare

Dosja e Ljubisha Dikoviçit (Diković Ljubiše)



HIIndexOut: 019-3173-3
Beograd, 23.01.2012.

1. Ljubisha Dikoviç, gjeneral-nënkolonel i Armatës së Serbisë (AS) deri më 12.12.2011, në detyrën e komandantit të Armatës tokësore të AS. Në vitin 1999, oficer i Armatës së Jugosllavisë (AJ) me gradën e nënkolonelit dhe komandant i brigadës së 37-të të motorizuar të AJ (në tekstin e mëtejshëm: br 37 mot.), i Korpusit të Uzhicës (në tekstin e mëtejshëm: KU)), i Armatës së Dytë (në tekstin e mëtejshëm: a 2) të AJ, br 37 m, e cila ka qenë stacionuar në Rashkë dhe, së këndejmi, është e njohur si “Brigada e Rashkës”.

1

Më 12.12.2011, kryetari i Republikës së Serbisë ka caktuar gjeneral-nënkolonelin Ljubisha Dikoviç si kryeshef të Shtabit të Përgjithshëm të Armatës së Serbisë.

Dikoviç ka lindur më 22. 05. 1960 në Uzhicë, Serbi. Në Armatë është i pranishëm që nga data 15.08.1979. Gjatë vitit 1994 dhe 1995, Dikoviç ka qenë komandant i batalionit të 16-të kufitar dhe, në atë cilësi, si vartës i Nikolla Markoviçit (Nikola Marković), Ivan Maksimoviçit (Ivan Maksimović) dhe nënoficerëve të tjerë, ka marrë pjesë në burgosjen e myslimanëve, të cilët, duke ikur nga Armata e Republika Srpskës, kanë kërkuar shpëtim në Serbi. Shumë myslimanë të zhvendosur dhe të zënë, pa dokumente, kurse në disa raste edhe nëpërmjet të listës përcjellëse dhe dokumenteve të tjera, ua kanë dorëzuar pjesëtarëve të shërbimeve ushtarake, policore dhe të atyre civile të fshehta të Republika Srpskës, të cilët shumë myslimanë të kthyer i kanë vrarë. Janë gjetur dhe në mënyrë të besueshme janë identifikuar mbetjet mortore të katër, prej pesë myslimanëve të kthyer, në mesin e të cilëve është edhe Suljo Rahmanoviç (Rahmanović Suljo), mysliman nga fshati Zapolje, komuna e Bratuncit.¹

¹ Baza e të dhënave e FDH, deklaratë e dëshmitarit X2000: „Deri tek të dhënat kam ardhur nga biseda me

2. Me urdhrin e Shtabit të Përgjithshëm të AJ, të datës 29.07.1998, br. 37 mtr. më datën 7.03.1999, i është bashkëngjitur korpusit 52 (të Prishtinës) të Armatës së Tretë të AJ.

3. Nën komandën e Dikoviqit, nga muaji maj i vitit 1988, në br. 37 mtr., shumë oficerë të Sigurimit ushtarak, në mesin e të cilëve edhe nënkolonelët Sllobodan Stoshiqi (Slobodan Stošić) dhe Miodrag Gjorgjeviqi (Miodrag Đorđević), i kanë stërvitur dhe ushtruar grupet e vrasësve, të kriminelëve, madje edhe disa dhjetëra vrasës të dënuar të burgut të Mitrovicës së Sremit. Nga korriku i vitit 1998, ata i kanë sjellë në Kosovë si vullnetarë dhe pjesëtarë të AJ. Shumë nga vrasësit e dënuar, sipas kërkesave të shërbimeve të fshehta ushtarake dhe policore, gjykatat në Serbi i kanë liruar nga pjesa e mbetur e dënimit me burgosje dhe i kanë lëshuar në liri. Nënkoloneli Stoshiq ua ka dhënë uniformat, armët më të rrezikshme, mjetet kimike dhe të tjera për liqumë të heshtur, dokumentet e legjitimitetit dhe shenjat e pjesëtarëve të sigurimit Ushtarak.

4. Më datën 20.04.1999, komandanti Dikoviq e ka urdhëruar kapitenin Dragan Mitroviqin (Dragan Mitrović) dhe kapitenin Bora Axhemoviq (Bora Adžemović) që, nga pozitën luftuese, të vinin tek ai së bashku në një makinë, në vend se në mënyrë individuale dhe me kujdes, siç e kërkojnë rregullat. Automjeti, në të cilin pos Mitroviqit dhe Axhemoviqit ishin edhe tre ushtarë në përcjellje, Aleksandër Milenkoviqi (Aleksandar Milenković), Sllobodan Çabarkapa (Slobodan Čabarkapa) dhe Boban Nastiqi, (Boban Nastić), ka hasur në vendin e quajtur "Lagja e Istogut (Skënderaj) në pritë të UÇK-së dhe me atë rast kanë humbur jetën të pesë pjesëtarët e AJ.³

2

5. Më datën 7.03.1999 ose për afërsisht në atë datë, koloneli Dikoviq, si komandant i br. 37 mtr. nga kazerma në Rashkë, e ka sjellë në Kosovë Grupin Luftarak (GL 37), që numëronte rreth 400 pjesëtarë. Prej këtij numri, rreth 250 pjesëtarë (oficerë, nënoficerë dhe ushtarë) të

disa oficerë të ish APJ dhe UJ. Letërnjoftimin e të vrarit Suljë Rrahmanoviq, si dhe listat përcjellëse me të dhënat e identifikimit të katër personave të kthyer dhe të vrarë myslimanë, i ruan në shtëpinë e tij Qedomir Milijashaeviç (Čedomir Milijašević) aso kohe zëvendës i Çetës së Parë të batalionit kufitar. Një nga pesë myslimanët, me anë të listës së përkohshme, i ka marrë një ushtar, sipas marrëveshjes, Jelisavqiç (Jelisavčić), me emër të panjohur, nga kulla e vrojtimit Jagoshticë (Jagoštica) nga formacioni i Çetës së Parë të batalionit 16 kufitar. Dragan Mitroviqi (Dragan Mitrović), komandant i Çetës së Parë të batalionit 16 kufitar, të pesë myslimanët e zënë rob, më 24 korrik të vitit 1995, ia ka dorëzuar Nikolla Markoviqit (Nikola Marković), komandantit të batalionit 16 kufitar, kurse ky dy prej tyre ia ka dorëzuar M. Tadiçit (M. Tadić), inspektor RPB-a i Bajina Bashtës (Bajina Bašta) si referent për çështje kufitare, kurse dy të tjerë ia dorëzuar Boshko Boshkoviqit, komandant i Batalionit të Skelës të URS. Tadiçi dhe Boshkoviqi, të katër boshnjakët ia kanë dorëzuar pjesëtarëve të sigurimit dhe ata, pas marrjes në pyetje, i kanë vrarë të katërtit, kurse mbetjet e tyre janë identifikuar dhe të gjitha të dhënat më të afërta në lidhje me zhvarrosjen dhe identifikimin i dijnë Ivan Maksimoviçi (Ivan Maksimović), oficer i sigurimit të batalionit 16 kufitar dhe Qedomir Milijashaeviçi (Čedomir Milijašević), zëvendës i komandantit të Çetës së Parë të batalionit 16 kufitar, i cili edhe i ka dokumentet në lidhje me zënien rob, dorëzimin, zbulimin e mbetjeve mortore dhe identifikimin“.

2 Baza e të dhënave e FDH, deklaratë e dëshmitarit X2000.

3 Baza e të dhënave e FDH, deklaratë e dëshmitarit X2000: "Oficerët dhe ushtarët janë vrarë me datën 20.04. të vitit 1999, në Drenicë. Dikoviqi dhe eprorët, të cilët kanë qenë të njohur me rastin, i kanë fshehur rrethanat e vërteta të vrasjes, por familja e majorit Mitroviç më vonë i ka ditur ato." VSCG KPP, *Lista...*, FHP-8817; OKMSSRJ, *Smrtno...*, FHP-10832; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 85, 211, 230, 237, 336. .



AJ kanë qenë nga br. 37 mtr., Administrata e Sigurimit të Armatës dhe të shumë qendrave të kundërzbulimit, kurse rreth 150 prej atij numri kanë qenë vullnetarë të përgatitur dhe të ushtruar mirë, në mesin e të cilëve me dhjetëra vrasës të dënuar, kriminel, kriminel të luftës, kanë qenë nën komandën e nënkolonelit Sllobodan Stoshiqit⁴ dhe Miodrag Gjorgjeviqit.⁵

4 GJNPJ, lënda nr. IT-05-87-T, *Prokurori kundër Millutinoviqit dhe të tjerëve*, lëndë e dëshmisë me numër P2671, deklaratë e dëshmitarit Gjoroviq Llakiq (Lakića Đorovića), e dhënë hetuesve të Prokurorisë së GJNPJ me datën 1. 09. 2006, paragrafet 22 - 39; GJNPJ, lënda nr. IT-05-87-T, *Prokurori kundër Millutinoviqit dhe të tjerëve*, transkripte të dëshmisë së Qoroviq Llakiqit me datën 11-13. 03. 2007: „ Sllobodan Stoshiq (Slobodan Stošić), 1991. kapitan i Klasit të Parë të Sigurimit Ushtarak (SU) APJ – të Ushtrisë së Jugosllavisë (APJ-UJ), me shërbim në Administratën e Sigurimit (AS ; PU 9922 Beograd) të Sekretariatit Federativ për Mbrojtjen Popullore (SFMP, më vonë Ministria e Mbrojtjes - MM e RSJ). Një kohë, për vrasjen e 38 civilëve në Kosovë, ka qenë i dënuar dhe dënimin me burgosje e ka vuajtur në Mitrovicën e Sremit. Shef i Sigurimit të Brendshëm të SFMP, nga mesi i vitit 1997, i ka paraqitur Prokurorit Ushtarak në Beograd ndjekjen penale kundër Sllobodan Stoshiqit, për 17 (shtatëmbëdhjet) krime lufte dhe veprat më të rënda penale. Ndjekja penale në prokurori është e evidentuar si lënda I VTK nr 86/97. Nga 17 inkriminimet, më e buta është ajo mbi dërgimin e dhjetëra vrasësve, të dënuar me burgim në Mitrovicën e Sremit, në më të paku 10 (dhjetë) aksione të vrasjes së civilëve në Bosnjë, në Sllavoni dhe në Serbi (në Smederevë). Vrasësve të dënuar ua ka dhënë dokumentet e legjitimitimit dhe shenjat e shërbimit të sigurimit ushtarak, armët me bashkëkohore automatike (pushkë, revole automatike, bomba, harqe dhe mjete të tjera për likuidime të fshehta), iu ka dhënë veshje me shenjat e përkatësisë APJ -UJ, të Policisë Ushtarake ose të tjera, të njëjtit speciale të APJ – UJ. Shumë prej tyre iu ka dhënë vendime të përpiluara në mënyrë ilegale mbi të ashtuquajturin lirim nga përgjegjësia, mbi faljen ose zvogëlimin e pjesës së mbetur të dënimit me burgosje. Të dënuarit e tillë, disa herë, i ka dërguar të vrasin, të djegin, të rrënojnë, të vjedhin dhe të kryejnë krime të tjera. Disa prej tyre personalisht i ka vrarë pas aksioneve të kryera dhe gjatë ndarjes së presë së luftës. Disa prej tyre, gjoja, i ka pajisur me dokumentacion të udhëtimit në shtetet e tjera, me obligimin që të veprojnë sipas kërkesës së Stoshiqit ose të të tjerëve nga SU.

Stoshiq, në deklaratën me shkrim, ka pranuar secilin inkriminim, duke u shprehur në mënyrë vullgare se të gjitha këto inkriminime janë “gjepura” krahasuar me atë se çfarë ka bërë ai me kolonelin Radovan Radojeviqin (Radojević Radovanom), Sllobodan Tomiqin (Tomić Slobodanom) dhe Bogoljub Kijanoviqin (Kijanović Bogoljubom) nga SB SFMP. Ka pranuar edhe se ka poseduar mjete për likuidim të heshtur, por se ato i kanë poseduar të gjithë pjesëtarët e SB, madje në sasi pakrahasueshëm më të mëdha, si dhe mbi 10 (dhjetë) pushkomitrazet, pushkë automatike , automatik dhe revole automatike të modeleve dhe të kalibrave të ndryshëm. Ka pohuar se të gjitha mjetet, të cilat i ka fituar me detyrim, midis tyre edhe pesë 5 (pesë) modelet më të reja të automobilave të tipit *Pezho*, ia ka dhuruar shërbimit të Sigurimit Ushtarak në ditën e festës së saj – më 13 maj. Vilën në Dedinje dhe *Roleksin* nga ari i bardhë e kishte fituar në beteja, kurse diçka ka fituar edhe nga i dërguari ushtarak kinez, të cilit për punë seksi ia ka dërguar vajzat serbe më të reja se 9 vjet, me çka ka krijuar edhe xhirime komprometuese dhe ashtu e ka detyruar në bashkëpunim kundërzbulues në shërbim të SU.

Administrata e sigurimit ushtarak në vitin 1998 e ka drejtuar Stoshiqin në Kosovë, përmes Brigadës në Rashkë. Në Kosovë, gjatë viteve 1998 dhe 1999, në fshatrat dhe në rrethinat e pothuajse të gjitha komunave, ka kryer numër të madh vrasjesh dhe krime të tjera të rënda, me dijen dhe përkrahjen e superiorëve nga Sigurimi Ushtarak: Radojeviçi, Tomiçi dhe Kijanoviçi.

Me datën 3.09. 1999, Prokuroria ushtarake ka refuzuar fletëparaqitjen penale të shefit të SB SFMP⁶

5 GJNPJ, lënda nr. IT-05-87-T, *Prokurori kundër Millutinoviqit dhe të tjerëve*, lëndë e dëshmisë me numër P2671, deklaratë e dëshmitarit Gjoroviq Llakiqit e dhënë hetuesve të GJNPJ, 1. 09. 2006, paragrafi 38; GJNPJ, lënda nr. IT-05-87-T, *Prokurori kundër Millutinoviqit dhe të tjerëve*, transkripte të dëshmisë së Gjoroviq Lakiqit, 11. -13. 03. 2007; GJNPJ, lënda nr. IT-05-87-T, *Prokurori kundër Millutinoviqit dhe të tjerëve*, vendimi gjyqësor, paragrafet prej 495 deri 569, (f.153-173), paragrafet 758-764. (f. 335-337), dhe paragrafi 831 (f. 296 dhe 297).



6. Në mënyrë suksesive, nga data 2.04.1999, plotësisht e kompletuar, br. 37 e mtr. nga Rashka është zhvendosur në Kosovë, në zonën e Drenicës (Glllogovc, Klinë, Skenderaj)”, siç edhe ishte përcaktuar me planin “Bubullima 98.”⁶

Me mbi 4.500 pjesëtarë të br. 37 mtr., të ndarë në grupe luftarake, me mbështetjen e blinduar të 31 tankseve dhe një divizioni artilerik me 18 armatime të tipit të obusit 105 mm, me minahedhës 82 mm dhe 120 mm, nën komandën e kolonelit Dikoviç dhe komandantëve vartës të tij të batalionit dhe komanduesit të njëjësive themelore, ata e kanë filluar “spastrimin” e hapësirës së Drenicës nga “forcat terroriste shqiptare.”⁷

7. Dikoviçi ka marrë pjesë në përvetësimin e pronave të shqiptarëve, jo vetëm në zonën e Drenicës, por në tërë Kosovën. Nga miniera e Bellaqevcit, gjatë vitit 1998, me urdhrin e Dikoviçit në Rashkë, është sjellë një eskavator-gërmues, i cili i është shitur një personi privat. Gjatë bombardimit të NATO-s, me dijeninë e tij, me mijëra automjete të shtrenjta të udhëtarëve, kamionë, traktorë dhe autobusë, janë bartur dhe shitur në Novi Pazar dhe Rashkë. Për vete personalisht e ka mbajtur një *Landrover* të shtrenjtë amerikan dhe një *Mercedes 300*. Automjetet e marra dhe të vjedhura i kanë ruajtur rojat ushtarake në fshatin Rvati, pranë depove ushtarake dhe rezervave në Banjën e Novipazarit, komuna e Novi Pazarit. Në mesin e oficerëve dhe ushtrisë është folur se Dikoviçi në kohën e fushatës së NATO-s është bërë pronar i mijëra krerëve të bagëtisë së trashë dhe të imtë, të marrë nga shqiptarët e Kosovës.⁸

4 II Vrasjet masive në zonën e Kosovës, ku kanë qenë të pranishme njësitë nën komandën e Ljubisha Dikoviçit

Disa grupe luftarake të br. 37 mtr., kanë qenë pandërprerë të pranishme në Kosovë që nga muaji maj i vitit 1998. Brigada e plotë ka qenë e pranishme nga data 7.03.1999 deri në ardhjen e forcave ndërkombëtare me datën 11. 06.1999. Në atë periudhë, pavarësisht ose në bashkëveprim me veprimet e tjera ushtarake të AJ, br. 37 mtr., nën komandën e Ljubisha Dikoviçit ka vepruar si mbështetje me anë të zjarrit dhe përgatitje për sulmin e njëjësive të MPB/AJ në fshatrat shqiptare, në të cilat janë kryer vrasje të shumta masive të civilëve shqiptarë, dhunime, plaçkitje dhe shkatërrim i pronës.

1. Çikatovë e Vjetër, Glllogoc

1.1. Në orët e hershme të mëngjesit, më datën 17.04.1999, forcat e AJ/MPB-së e kanë rrethuar fshatin Çikatovë e Vjetër. Pas granatimeve në të gjitha anët me armë artilerike, me topa të tipit të tankeve, me minahedhës dhe veprime me të gjitha armatimet në dispozicion mbi shtëpitë dhe mbi të gjitha objektet, kanë hyrë në fshat rreth orës 6 të mëngjesit. Në grupe prej 3 deri në 5 pjesëtarë, ushtarët/policët kanë sulmuar shtëpitë, kanë rrahur,

6 GJNPJ, lënda nr. IT-05-87-T, *Prokurori kundër Millutinoviçit dhe të tjerëve*, lëndë e dëshmisë me numër 4D00140, Dokument i Komandës së Armatës së Tretë UJ, „Bubullima 98“, Urdhër për thyerjen e FTD dhe i forcave të kryengritjes së armatosur në K e M, DT. nr. 6034-7/1, 29.07.1998.

7 Baza e të dhënave të FDH, dëshmitari X2000.

8 Baza e të dhënave të FDH, dëshmitari X2000.



keqtrajtuar, i kanë poshtëruar dhe me veprime brutale i kanë frikësuar të gjithë familjarët e gjetur në ato shtëpi, duke synuar që t'i detyrojnë e t'ua marrin paratë, stolitë dhe të gjitha gjërat e tjera të çmueshme personale. Shumë persona i kanë lënduar rëndë, kurse disa të tjerë i kanë vrarë në shtëpitë e tyre, para familjarëve dhe fqinjëve të tyre. Të mbijetuarit i kanë nxjerrë nga shtëpitë dhe, duke i rrahur pandërprerë e duke i mbajtur nën kërcënimin e armëve, i kanë tubuar në disa vende në fshat. Numrin më të madh prej tyre, kryesisht nga familja Morina, i kanë tubuar në lagjen e tyre të quajtur Morinë. Pas kontrollit të serishëm dhe rrahjes, i kanë ndarë meshkujt nga gratë dhe fëmijët. Shtëpitë dhe të gjitha objektet e tjera të fshatit menjëherë i kanë djegur. Femrat dhe fëmijët, nën kërcënimin e armëve, i kanë futur në kolonë dhe i kanë dëbuar nga fshati në drejtim të Gllogocit. Disa nga meshkujt e ndarë i kanë vrarë menjëherë, në vendin ku i kanë zënë, kryesisht duke shtënë në ta nga armët automatike, nga afërsia. Të tjerët i kanë ndarë në tri grupe dhe i kanë çuar në oborret e kushërinjve të tyre – Ylber Morinës, Ali Morinës dhe Sejdi Morinës dhe, nga afër, kanë shtënë në ta me rafalë plumbash. Me këtë rast i kanë vrarë disa dhjetëra shqiptarë nga ky fshat, midis të cilëve 27 në mënyrë të besueshme të identifikuar.⁹

2. Qirez, komuna e Skënderajt

Njësia prej rreth 100 ushtarësh dhe paramilitarësh, më datën 17.04.1999, rreth orës 7:00, ka hyrë në fshatin Kozhicë. Në grupe prej 2 dhe 3 ushtarësh, kanë shkuar prej shtëpie në shtëpi dhe me dhunë e nën kërcënimin e armëve, nga familjarët dhe nga personat e tjerë shqiptarë të ndjekur nga zonat e tjera, kanë rrëmbyer paratë, stolitë, gjërat e çmueshme dhe të gjitha gjërat e tjera personale të vlefshme. Rreth 115 shqiptarë kosovare – vajza, gra, fëmijë dhe plaka – i kanë ngujuar në shtëpinë familjare të Abedin Durmishit. Në përdheshin e kësaj shtëpie i kanë ngujuar gjithsejtë 31 gra dhe fëmijë. Shpejt i kanë sjellur edhe 88 gra shqiptare dhe fëmijë dhe 28 nga ata i kanë mbyllur në katin e parë, kurse rreth 60 në katin e dytë të shtëpisë së Abedin Durmishit.

Pas dy ditësh, një grup i ushtarëve të AJ, nga grupi prej 31 grave dhe fëmijëve në përdhesh, i ka dërguar 27 gra dhe fëmijë në fshatin Qirez. Aty ia kanë dërguar grupit prej 10 ushtarësh të veshur në “uniforma të kafta të kuqe të maskuara”, të cilët i ka udhëhequr një epror me shenjat e paletave në kraharor. Në kërcënimet se do t'i vrasin së bashku me fëmijët, ua kanë

9 Baza e të dhënave të FDH: 1) Rexhep (Sheremet) Morina (11.07.1938), 2) Brahim (Sheremet) Morina (27.03.1957), 3) Sheremet (Rexhep) Morina (15.05.1971), 4) Avdyl (Hazir) Morina (1938), 5) Emin (Sadri) Morina (20.06.1958), 6) Selim (Sadri) Morina (22.09.1967), 7) Tahir (Zeqir) Morina (27.04.1951), 8) Gani (Haxhi) Morina (21.06.1949), 9) Sylë (Haxhi) Morina (25.03.1935), 10) Beqir (Jashar) Morina (16.05.1943), 11) Daut (Jashar) Morina (13.08.1931), 12) Sabit (Ali) Morina (30.07.1956), 13) Beqir (Zeqir) Morina (08.10.1945), 14) Arif (Zeqir) Morina (12.11.1920), 15) Muharrem (Rrustem) Morina (1912), 16) Kadri (Haradin) Morina (15.05.1937), 17) Isuf (Fetah) Morina (21.12.1948), 18) Bahtir (Hetem) Morina (14.02.1942), 19) Tahir (Hetem) Morina (10.04.1937), 20) Afrim (Bahtir) Morina (15.03.1965), 21) Bajram (Veseli) Makolli (06.10.1925), 22) Florim (Tahir) Morina (07.04.1962), 23) personi invalidor Azem (Bajram) Morina (1930); 24) Zenel (Sylë) Morina (01.02.1930), të gjithë nga fshati Çikatovë e Vjeter, 25) Kadri (Tahir) Karagja (22.03.1922), 26) Haxhë (Hazir) Demaku (15.06.1980), nga fshati Obri e Epërme. Me këtë rast, shumë persona kanë marrë plagë të rënda, plagë të rrezikshme për jetën, nga të cilat disa së shpejti kanë vdekur, kurse në mesin e tyre është edhe 27) Merrushe (Hys) Shala (1970), nga fshati Sankoc.



marrë dokumentacionin personal, të hollat dhe stolitë e pastaj dy ushtar i kanë dërguar te njëfarë hambari dhe të gjithë i ka mbyllur aty. Nga grupi i personave të mbyllur me dhunë, i ka ndarë një numër më të madh vajzash dhe grash të reja, prej të cilave disa kanë qenë me një shtatëzani të shtyer, (prej muajit të katërt deri në muajin e nëntë)¹⁰. Disa herë i kanë nxjerrë gratë dhe vajzat jashtë hambarit dhe shumë herë i kanë detyruar në marrëdhënie seksuale vagjinale dhe, po ashtu, i kanë keqtrajtuar dhe shfrytëzuar seksualisht edhe në forma të tjera. Po atë ditë, pesë nga këto vajza të dhunuara¹¹, si dhe tri gra shqiptare më të vjetra, Miridije Dibrani, Tahire Shalaku dhe Fahrije Ademi, i kanë ndarë nga grupi, i kanë nxjerrë nga hambari dhe, më vonë, tash për tash në një ditë ende saktësisht të pavërtetuar, i kanë vrarë dhe i kanë hedhur në tre bunarë në Qirez, ku janë gjetur kufomat dhe janë identifikuar në muajin korrik të vitit 1999.¹²

3. Shavarinë, fshati Çikatovë e Vjetër

Më datën 30.04.1999, rreth orës 5:00, forca të shumta të AJ/MPB-së e kanë rrethuar dhe në të gjitha drejtimet i kanë granatuar me dhjetëra fshatra në komunat Gllogoc dhe Skenderaj. Shqiptarët nga këto fshatra me panik i kanë braktisur shtëpitë e tyre, duke kërkuar shpëtim në pyjet dhe bjeshkët për rreth. Gratë, fëmijët, pleqtë dhe të pafuqishmit, të cilët nuk ia kanë dalë të braktisin fshatrat, janë grumbulluar në shkollat fillore vendore dhe/ose janë fshehur në bodrumet e shtëpive. Forcat e RSJ/Serbisë edhe ata i kanë ndjekur nga fshatrat, kurse e kanë vazhduar kërkimin e shqiptarëve të ikur në pyje dhe bjeshkë. Shumë prej tyre i kanë vrarë ose i kanë plagosur rëndë, menjëherë pasi i kanë zbuluar, në vendet ku i kanë gjetur ose në veprim e sipër.

6

Disa qindra shqiptar të paarmatosur, meshkuj, fëmijë, gra, pleq dhe persona të pafuqishëm, ushtarët dhe policët i kanë tubuar në grupe më të mëdha, në më shumë vende e, pastaj, duke i rrahur dhe ua rrëmbyer gjërat e tyre personale, nën kërcënimin e armëve, i kanë sjellë në fshatin Qirez, komuna e Skenderajt.

3.1. Pjesëtarët e AJ/MPB-së i kanë mbajtur në oborrin e xhamisë rreth 250 shqiptarë, kryesisht fshatarë, prej të cilëve 25 më të rinj se 18 vjet (të moshës jomadhere), deri në orët e hershme të mbrëmjes së asaj dite. I kanë rrahur me vrazhdësi dhe i kanë frikësuar, i kanë kontrolluar dhe ua kanë marrë paratë, stolitë dhe të gjitha gjërat e tjera personale të vlefshme. Ismet (Haxhi) Prokshin (1.05.1964), nga fshati Vrboc, komuna e Gllogocit, të cilin e kishin lënduar rëndë gjatë zënies, e kanë sjellë në oborrin e xhamisë të lidhur për

10 Me qëllim të mbrojtjes së identitetit të vajzave dhe të grave, të cilat kanë mbijetuar, FDH nuk i përmend emrat e tyre.

11 Baza e të dhënave të FDH: pesë shqiptare të reja të dhunuara e, pastaj, të vrara, vajza dhe gra: Zahide Xhema, e moshës 19 vjeçare; Lumnije Zymberi, e moshës 20 vjeçare; Antigona Dibrani, e moshës 20 vjeçare; Bukurije Dibrani, e moshës 18 vjeçare; Mirishahe Dibrani, e moshës 17 vjeçare; Xhevahire Rrahmani, e moshës 33 vjeçare; Fahrije Zymberi dhe Violeta Shalaku, të cilat kanë qenë në muajin e tetë të shtatëzanisë. GJNPJ, lënda IT-02-54, *Prokurori kundër Sllobodan Milloseviqit*, lëndë e dëshmisë me numër P141, deklaratë e dëshmitares Xhevahire Rrahmani.

12 GJNPJ, lënda IT-02-54, *Prokurori kundër Sllobodan Milloseviqit*, lëndë e dëshmisë me numër P141, deklaratë e dëshmitares Xhevahire Rrahmani.



tanksi. Një kapiten i pidentifikuar i AJ e ka vrarë në grumbullin e plehut të stallës në fund të oborrit të xhamisë, me rafalë duke ia zbrazur gjithë karikatorin prej tridhjetë plumbash në shpinë. Ushtarët, me urdhrin e kapitenit, e kanë futur në atë stivë . Ismet Dvoranit, nga fshati Shtuticë, komuna e Gllgocit, një nga policët e PPJ (PJP), me majën e tehut të thikës në ballë ia ka gdhendur kryqin me katër shigjeta, përkatësisht shkronjën C, duke i detyruar të gjithë të pranishmit e tjerë që të shikonin dhe duke i kërcënuar se edhe ata i pret po ajo gjë.

3.2. Të nesërmen, herët në mëngjes, në datën 1.05.1999, në xhami kanë hyrë pjesëtarët e PPJ dhe të Njësave për Operacione Speciale (NjOS), të njohur si Frenkit e në mesin e tyre edhe njëfarë Çarli, si udhëheqës dhe prijës, dhe Nikçi dhe Gjuka si vartës të tij. Një grup të shqiptarëve, rreth mesditës së datës 1.05. 1999, i kanë ndarë dhe me kamionin e AJ i kanë dërguar në stacionin policor të Gllgocit. Ia kanë dorëzuar komandantit Dragan Miriç dhe policëve të këtij stacioni.¹³

3.3. Menjëherë pas ndarjes dhe dërgimit të këtij grupit të parë në stacionin policor në Gllgoc, pjesëtarët e PPJ-së, në mesin e të cilëve edhe Sllavko, Gjura dhe NN me nofkën »Komandanti«, rreth orës 14:00 të datës 1.05.1999, i kanë ndarë rreth 90 shqiptarë të zënë rob. Në xhami i kanë lënë rreth 110, në mesin e të cilëve edhe 25 të moshës jomadhore. Të zënë rob, të cilët i kishin ndarë, pjesëtarët e PPJ dhe të AJ i kanë futur në dy kamionë. Njëri ka qenë ushtarak, me ngjyrë të hirtë ulliri, kurse tjetri civil, me ngjyrë të verdhë. Të zënë rob, me anë të rrugëve lokale i kanë dërguar në drejtim të Gllgocit.

3.4. Në kamionin ushtarak, në karrocerinë me grila, i cili ishte nisur si i pari, i kanë futur 44 shqiptarë. Rreth orës 14:30, e kanë ndalur kamionin Te Shavarinat (gropa dhe gërmime, të krijuara nga gërmimi i xehes për fabrikën e Feroniklit) në fushën e fshatit Çikatovë e Vjetër. Me urdhrat e pjesëtarit të PPJ, të quajtur "komandanti", pjesëtarët e tjerë të PPJ dhe disa ushtarë, i kanë rreshtuar shqiptarët e zënë rob menjëherë afër skajit të njëres prej gropave dhe, bashkë e në të njëjtën kohë, me rafalë plumbash kanë shtënë mbi ta, duke shtënë pandërprerë derisa secili prej katër dhjetë e tre prej tyre nuk është hedhur në gropë. Në gropë, në grumbullin e të pushkatuarve, e kanë hedhur edhe një të vrarë në kamion, kurse, pas kësaj, kanë hedhur shumë bomba dore. Nga pushkatimi ka mbijetuar vetëm Behar Topilla, i cili kishte rënë në gropë në mesin e njerëzve të parë të pushkatuar. Pas një kohe të caktuar, kur i është kthyer vetëdija dhe është bindur se nuk ka rrezik, Topilla është tërhequr nga të vrarët.

3.5. Shqiptarët e zënë rob në karrocerin e kamionit të verdhë civil, i cili ishte nisur si kamioni i dytë pas atij ushtarak, pas rreth 10 kilometrash të vozitjes, policët i kanë sjellë te Te Shavarinat. Aty, të zënë rob, kanë parë se si "policët", nga largësia prej rreth 10 metrash, me rafalë plumbash kanë shtënë mbi shqiptarët e rreshtuar dhe se si hidheshin ata në atë

13 Baza e të dhënave të FDH: Shqiptarët e zënë rob, pasi janë marrë në pyetje në stacionin policor në Gllgoc, janë dërguar në burgje, kryesisht në Prishtinë ose Lypjan. Më vonë, numri më i madh i tyre janë transferuar në BKN Dubravë në Istog, ku disa, në maj të vitit 1999, i kanë vrarë rojat e burgut dhe pjesëtarët e forcave të policisë speciale të MPB të Serbisë.



gropë. Derisa e kanë parë dhe dëgjuar këtë, policët pandërprerë iu kanë folur se si do t'i pushkatojnë të gjithë. Megjithëkëtë, nuk i kanë pushkatuar. Të gjithë i kanë dërguar në stacionin policor në Glllogoc, ku i kishte pranuar komandanti Dragan Miriç dhe policët e këtij stacioni dhe ua kishin bashkëngjitur shqiptarëve të tjerë të ndaluar më herët aty.

3.6. Grupit të shqiptarëve, të cilët më datën 1.05.1999 i kanë mbajtur dhe marrë në pyetje në stacionin policor në Glllogoc, policët, më datën 3.05.1999, ia kanë bashkëngjitur edhe 14 shqiptarë nga famija Veliqi, fshati Polluzhë.¹⁴ Në stacionin policor në Glllogoc, me datën 6.05.1999, gjithsejtë kanë qenë 76 shqiptar të zënë rob. Atë ditë, komandanti Miriç dhe policët e stacionit policor të Glllogocit, ia kanë dorëzuar pjesëtarëve të policisë ushtarake të gjithë, 76 shqiptarët, të cilët, po atë ditë, pas rrahjes brutale, ia kanë dorëzuar majorit Puzi, kapitenit Angjelkoviç dhe oficerëve të tjerë, nënoficerëve dhe ushtarëve të AJ, divizioni i Obusit 105 mm dhe njësitë e tjera të AJ, në atë kohë të stacionuara në fshatrat Peterk, Vukoc dhe Krajkovë. Pjesëtarët e këtij divizioni dhe të njëjstëve të tjera të AJ, i kanë detyruar këta 76 shqiptarë të Kosovës që çdo ditë të hapin istikame, kanale, rrugë dhe të kryejnë punë të tjera, të dëmshme edhe për shëndetin e edhe për jetën.

3.7. Më datën 13.05.1999, pjesëtarët e AJ, nga 76 shqiptarët e zënë rob, i kanë ndarë dhe, në drejtim të panjohur, me një kamion ushtarak, i kanë dërguar 13 shqiptarë.¹⁵ Disa nga eprorët vartës të majorit Puzoviç, të quajtur Puza, dhe të kapitenit Angjelkoviç nga divizioni i Obusit, kanë folur para shqiptarëve të mbetur nga grupi prej 76 shqiptarësh - se këta 13 shqiptarë janë sjellë te Te Shavarinat në fshatin Çikatovë e Vjetër, që t'i zhvarrosin dhe t'i zhvendosin trupat e shqiptarëve të vranë dhe, kur e kanë bërë këtë, edhe vet ata të trembëdhjetët i kanë vranë dhe i kanë fshehur që askush të mos i gjejë.

3.8. Në orët e vona të pasdites, me datën 1.05.1999, policët dhe pjesëtarët e PPJ dhe pjesëtarët e AJ, nga grupi prej rreth 110 shqiptarësh të ngujuar në xhami në Qirez, i kanë

14 Baza e të dhënave të FDH: Bajram Veliqi, djali i tij Besimi (23), Bekimi (21), Safeti (13), Kadriu (35), Islami (65), Mustafa (63), Fatoni (35), Sadiku (15), Mexhidi (27), Ferati (43), Zeneli (21), Milaimi (15) dhe Faik Veliqi (20).

15 Baza e të dhënave të FDH; deklaratë e Z.K. FDH-258: (...) Në ditën e 10 majit, në mëngjes, Majori Puzo i kishte ndarë 13 meshkuj nga grupi ynë, të cilët me kamion i kanë dërguar në një drejtim të panjohur, që pastaj zhduken. Pas përfundimit të luftës, nuk e di se si, është kuptuar se ata kanë qenë të detyruar të punojnë në hapjen e varrezave masive, punë pas të cilës janë zhdukur, me gjasë janë vranë, por, megjithëkëtë, trupat e tyre nuk janë gjetur dhe as që ka ndonjë gjurmë e cila tregon se ata janë të vranë. Këta janë emrat e 13 meshkujve të ndarë: Besim Veliqi, Zenel Veliqi, Mustafë Veliqi, nga fshati Polluzhë, pastaj Rrahim Prokshi, Arben Gashi, Ramadan Shala, Selami Dobra, Ismet Dobra së bashku me djalin, emrin e të cilit nuk e di, nga fshati Verboc, Ferat Krasniqi, Abedin Nika dhe Shefqet Karaqica nga fshati Gllanasellë, dhe Nebi Dervisholli nga fshati Gradicë. Ne të tjerëve na kanë mbajtur në fshatin Krajkovë deri me datën 15.06. 1999, kur edhe na kanë liruar. Unë menjëherë kam shkuar në fshatin tim – Gllanasellë. Baza e të dhënave të FDH; deklaratë e Rifat Bilallit, FDH-2583:” Ferat Veliqi, i cili ka qenë me grupin e të zënëve rob në fshatin Kajokovë, më ka treguar se kur i kanë ndarë 13 meshkujt, një ushtar epror , i cili ka qenë përgjegjës për grupin, ka thënë se ata meshkuj do të hapin varreza masive dhe, pasi ta kenë kryer këtë punë, të gjithë do të pushkatohen. Jam i bindur se ashtu edhe ka ndodhur. Trupat e tyre nuk janë gjetur kurrë.”



mbajtur 25 shqiptar të moshës jomadhore¹⁶ kurse të tjerët, mbi 70 prej tyre, midis të cilëve edhe Xhafer Veliun, të cilin e kanë ndarë nga djali i tij trembëdhjetëvjeçar Shyqriu, i kanë nxjerrë nga xhamia dhe i kanë futur në dy kamionë: një prej tyre kamion ushtarak, me ngjyrë hiri-ulliri, dhe në një kamion tjetër civil, me ngjyrë të verdhë. Së pari i kanë futur në kamionin ushtarak e pastaj në atë civil. Në kamionin civil, si të fundit nga grupi i shqiptarëve të moshës madhore, e kanë futur Xhafer Veliun. Para se ta fushnin në kamion, Xhaferi e ka dëgjuar njërin prej policëve kur i ka thënë një ushtari me nofkën “Bosanac”: «Bëni çfarë të doni me ata fëmijë, sepse ne më nuk kthehemi me kamionë.» Kamionët, para xhamisë së Qirezit, janë nisur në të njëjtën kohë dhe kanë vazhduar nëpër rrugët lokale drejt Glllogocit. I pari ka qenë kamioni ushtarak dhe në të kanë qenë rreth 40 shqiptarë. Kamioni civil me ngjyrë të verdhë ka vozitur pas atij ushtarak dhe në të kanë qenë rreth 30 shqiptarë të zënë rob, midis të cilëve edhe Xhafer Veliu. Te Shavarinat, në të njëjtin vend, në të cilin, po atë ditë, disa orë më parë, i kishin vrarë 43 dhe një tjetër e kishin plagosur rëndë, policët e PPJ dhe pjesëtarët e AJ i kanë ndalur të dy kamionët dhe i kanë zbritur të gjithë, të 70 shqiptarët e zënë rob. Të gjithë i kanë pushkatuar, pothuajse në të njëjtën mënyrë si edhe grupin tjetër paraprak, me ndryshimin që tash i kishin vrarë shqiptarët të ndarë në grupe prej dhjetë sish. Derisa 10 të zënë rob të fundit nga kamioni (i dytë) civil me ngjyrë të verdhë i kanë detyruar të shkojnë tek gropat për pushkatim, me një kërcim të shpejtë anash dhe duke ikur, kanë shpëtuar vetëm dy - Bajram Shabani nga fshati Dashec dhe Xhafer Veliu nga fshati Polacë.

3.9. Të gjithë, 25 shqiptarët e moshës jomadhore, të cilët forcat e AJ/MPB-së në datën 1.05.1999 i kishin mbajtur në xhami në fshatin Qirez, më vonë janë zhdukur dhe mbi fatin e tyre asgjë nuk është ditur. Pas luftës, në korrik të vitit 1999, në mesin e trupave të gjetur të shqiptarëve të moshës madhore, të vrarë në orët e pasdites të datës 1. 05.1999 Te Shavarinat në fshatin Çikatovë e Vjetër janë gjetur trupat e 17 shqiptarëve të moshës jomadhore. Deri më sot janë gjetur trupat e 24 shqiptarëve të moshës jomadhore¹⁷.

16 Baza e të dhënave të FDH, deklaratë e Xh. V, FDH-34968 (...): “Në mesin e 25 shqiptarëve të moshës jomadhore, të cilët janë ndarë dhe mbajtur në xhami në Qirez, kanë qenë: Nebih (Ali) Salihu dhe Mustafë (Zeqir) Kahrmani, të dytë nga fshati Baks, Kushtrim (Sokol) Krasniqi, nga fshati Gllansellë, Hazir (Lah) Dvorani dhe Burim (Ali) Aliu, të dytë nga fshati Qirez, Ibush (Selman) Gashi, Rafet (Bajram) Rrukiqi, Betim (Beqir) Prokshi, Shpejtim (Rizah) Prokshi, të katërtit nga fshati Vrboc, Ekrem (Ramadan) Morina, Jetullah (Ilaz) Ademi, Feriz (Ramadan) Ramadani, Safet (Dalip) Sokoli, Fejzë (Zeqir) Zeqiri, Ilir (Rizah) Beqiri, Bajram (Zeqir) Zeqiri, të shtatët nga fshati Shtuticë, Sami (Sefedin) Shishani, nga Pokleku i Ri, dhe djali im, Shyqriu.”

17 Baza e të dhënave të FDH: Nga 25 të ndarë të moshës jomadhore të mbajtur në xhami në fshatin Qirez, menjëherë pas luftës janë gjetur dhe identifikuar trupat e 18 të mëposhtëmve : 1) Shyqri (Xhafer) Veliu (05.03.1986), nga fshati Polac, 2) Nebih (Ali) Salihu (1984) dhe 3) Mustafë (Zeqir) Kahrmani (1985), të dytë nga fshati Baks; 4) Kushtrim (Sokol) Krasniqi (28.09.1984), nga fshati Gllansellë; 5) Hazir (Lah) Dvorani (01.07.1983) dhe 6) Burim (Ali) Aliu (1982), të dytë nga fshati Qirez ; 7) Ibush (Selman) Gashi (23.01.1982), 8) Rafet (Bajram) Rrukiqi (13.02.1983), 9) Betim (Beqir) Prokshi (05.09.1985), 10) Shpejtim (Rizah) Prokshi (15.10.1984), të katërtit nga fshati Vrboc; 11) Ekrem (Ramadan) Morina (15.10.1983), 12) Jetullah (Ilaz) Ademi (10.06.1984), 13) Feriz (Ramadan) Ramadani (11.04.1983), 14) Safet (Dalip) Sokoli (21.10.1983), 15) Fejzë (Zeqir) Zeqiri (10.09.1983), 16) Ilir (Rizah) Beqiri (22.09.1982), të gjithë nga fshati Shtuticë, dhe 17) Sami (Sefedin) Shishani (16.04.1982), nga Poklek i Ri. Më vonë janë identifikuar edhe mbetjet mortore të të tjerëve: 18) Aziz (Sadik) Heta (25.12.1981) dhe 19) Xhemajl (Hazir) Tahiraj (1983) të dytë nga fshati Çikatovë e Vjetër, 20) Ilir (Shaqir) Sejdiu (12.07.1981) nga fshati Likoshan, 21) Islam (Demir) Shaqiri



3.10. Nga shqiptarët, të cilët në mënyrë të besueshme është vërtetuar se me datën 30.04.1999 janë zënë rob dhe janë mbajtur në xhaminë e fshatit Qirez, kurse ty nesërmen, me datën 1.05.1999, me kamion janë dërguar në drejtim të Glllogocit dhe shumica e tyre janë pushkatuar Te Shavarinat, pas tërheqjes së forcave serbe nga Kosova, janë gjetur dhe, me analizën e ADN-së dhe në mënyra të tjera, në mënyrë të bindshme janë identifikuar trupat e 99 të vrarëve, prej të cilëve 24 të moshës jomadhore.¹⁸ Nuredin (Avdullah) Dvorani, i lindur

(06.05.1983) nga Prishtina, 22) Lutfi (Daut) Salihu (18.06.1981) nga fshati Qirez, 23) Xhavit (Sefer) Gjinovci (04.08.1983) nga fshati Makërmal, dhe 24) Bahri (Ragip) Sokoli (25.08.1981) nga fshati Shtuticë.

- 18 Baza e të dhënave të FDH: Në mënyrë të besueshme janë identifikuar 99 shqiptarët e vrarë, në mesin e të cilëve edhe 24 të moshës jomadhore: 1) Bekim (Murat) Bajraktari (01.09.1970), 2) Arben (Murat) Bajraktari (23.01.1975), 3) Shpend (Ali) Bajraktari (01.05.1971), 4) Xhevdet (Agush) Qorri (10.11.1975), 5) Shpend (Agush) Qorri (24.09.1978), të gjithë nga Glllogoci, 6) Shyqri (Xhafer) Veliu (05.03.1986), 7) Hamit (Isuf) Xhani (17.05.1939), 8) Arton (Hamit) Xhani (1980), 9) Tefik (Hamit) Xhani (1966), 10) Qazim (Isuf) Xani (1945), 11) Veton (Qazim) Xani (1980), të gjashtë nga fshati Polac; 12) Nebih (Ali) Salihu (06.06.1982), 13) Ferat (Tahir) Osmani (1928), 14) Driton (Rrustem) Halili (13.04.1977), 15) Ahmet (Sinan) Musliu (05.02.1981), 16) Mustafë (Zeqir) Kahirmani (28.04.1984), 17) Tahir (Liman) Tahiri (03.01.1936), të gjashtë nga fshati Baks, 18) Sokol (Adem) Krasniqi (13.10.1955), 19) Kushtrim (Sokol) Krasniqi (28.04.1984), 20) Halit (Brahim) Maloku (15.04.1946), 21) Nazmi (Tafil) Maloku (19.09.1953), 22) Sabit (Brahim) Maloku (05.06.1950), 23) Deli (Hajdin) Nika (1937), 24) Ahmet Llugani (1964), 25) Hajzer (Isuf) Karaqica (27.07.1965), të tetë nga fshati Gllanasellë, 26) Hysni (Alush) Morina (02.11.1976), 27) Izet (Rifat) Elshani (17.01.1974), të dytë nga fshati Glllobare, 28) Shpend (Bajram) Cakiqi (05.10.1980), 29) Mehmet (Murat) Dvorani (25.03.1955), 30) Hysni (Idriz) Dvorani (10.08.1971), 31) Haki (Idriz) Dvorani (11.04.1980), 32) Veli (Idriz) Dvorani (05.01.1976), 33) Avni (Idriz) Dvorani (03.10.1974), 34) Hazir (Lah) Dvorani (01.07.1983), 35) Nuhi (Lah) Dvorani (15.07.1975), të shtatë nga fshati Tërstenik, 36) Faton (Bajram) Shabani (06.06.1980), 37) Bexhet (Deli) Shabani (17.06.1972), 38) Naser (Deli) Shabani (01.10.1960), 39) Xhafer (Ali) Sinani (24.04.1951), të katërt nga fshati Dashec, 40) Ramadan (Mehmet) Rexhepi (01.01.1935), 41) Shaban (Mehmet) Rexhepi (1939), 42) Bajram (Hysen) Aliu (19.03.1953), 43) Ilmi (Rrustem) Aliu (28.05.1947), 44) Burim (Ali) Aliu (1982), 45) Ruzdi (Ilmi) Aliu (1978), 46) Ali (Rrustem) Aliu (12.01.1950), 47) Avni (Alush) Smajli (25.08.1975), 48) Lulzim (Avdyl) Ferati (05.01.1978), të dhjetë nga fshati Qirez, 49) Ismet (Haxhi) Prokshi (01.05.1964), 50) Gani (Smajl) Krelani (10.12.1965), 51) Ibush (Selman) Gashi (23.01.1982), 52) Rafet (Bajram) Rukiqi (13.12.1983), 53) Betim (Beqir) Prokshi (05.09.1985), 54) Shpejtim (Rizah) Prokshi (15.10.1984), 55) Nexhmedin (Rrahim) Prokshi (20.11.1974), 56) Bekim (Tahir) Prokshi (17.05.1976), 57) Rizah (Ramiz) Prokshi (27.02.1955), 58) Xhafer (Avdyl) Gashi (21.07.1954), 59) Adem (Avdyl) Gashi (02.12.1946), të njëmbëdhjetë nga fshati Vrboc, 60) Izet (Xhelil) Kastrati (22.06.1958), 61) Selman (Feriz) Istogu (17.02.1934), 62) Musa (Selman) Istogu (23.08.1955), 63) Zymer (Hashim) Veliqi (07.07.1955), 64) Agron (Qerim) Veliqi (18.10.1976), të pestë nga fshati Poluzhë, 65) Bahtir (Ramadan) Dervishi (15.01.1938), 66) Ekrem (Ramadan) Morina (15.10.1983), 67) Bajram (Latif) Morina (27.06.1958), të tretë nga fshati Çikatovë e Vjetër, 68) Gani (Xheladin) Hajra (25.12.1946), 69) Qamil (Halil) Baliu (31.05.1969), 70) Hamit (Ilaz) Ademi (02.07.1980), 71) Ejup (Zymer) Ademi (10.07.1943), 72) Jetullah (Ilaz) Ademi (10.06.1984), 73) Xhevat (Selim) Ademi (09.11.1979), 74) Muharrem (Ali) Bilalli (15.03.1938), 75) Hetem (Ali) Bilalli (14.07.1948), 76) Bilall (Ali) Bilalli (07.10.1948), 77) Izet (Muharrem) Bilalli (28.12.1970), 78) Milaim (Hetem) Bilalli (01.12.1979), 79) Ramadan (Feriz) Ramadani (19.05.1943), 80) Feriz (Ramadan) Ramadani (11.04.1983), 81) Safet (Dalip) Sokoli (21.10.1983), 82) Bahri (Ragip) Sokoli (25.08.1981), 83) Fejzë (Zeqir) Zeqiri (10.09.1983), 84) Sherif (Fejze) Zeqiri (20.01.1962), 85) Ilir (Rizah) Beqiri (22.09.1982), të tetëmbëdhjetë nga fshati Shtuticë, 86) Ilaz (Hisen) Avdyli (18.05.1943), 87) Islam (Hasan) Hasani (24.12.1952), 88) Shahin (Islam) Hasani (15.02.1976), 89) Tahir (Adem) Azemi (20.02.1940), 90) Rrahman (Shaban) Nura (02.05.1958), 91) Xhemë (Ferati) Sejdiu (17.05.1965), 92) Ilir (Shaqir) Sejdiu (12.07.1981), të shtatë nga fshati Likoshan, 93) Faton (Miftar) Kiqina (29.09.1979), nga fshati Bajcë, 94) Sami (Sefedin) Shishani (16.04.1982), 95) Arton (Brahim) Shishani (16.06.1980), nga fshati Poklek i Ri, 96) Afrim (Xhafer)

10



me datën 28.09.1982 në Tërstenik, edhe më tutje konsiderohet si person i zhdukur.

3.11. Nga shqiptarët, për të cilët në mënyrë të besueshme është vërtetuar se me datën 30.04.1999 janë zënë rob dhe janë mbajtur në xhaminë e fshatit Qirez, kurse me datën 1.05.1999 janë nxjerrë nga xhamia, janë futur në kamionë dhe janë dërguar në drejtim të Glllogocit, 6 prej tyre ende konsiderohen si të zhdukur¹⁹. Të gjithë, për herë të fundit janë parë të gjallë me datën 1.05.1999 Te Shavarinat në fshatin Çikatovë e Vjetër.

3.12. Nga shqiptarët, për të cilët në mënyrë të besueshme është vërtetuar se me datën 30.04.1999 kanë qenë në xhaminë e fshatit Qirez, kurse me datën 1.05.1999 janë futur në kamiona dhe Te Shavarinat janë sjellë për pushkatim, kanë mbijetuar vetëm tre prej tyre dhe ata janë: Behar (Ibrahim) Topilla (30. janar 1980), Xhafer Veliu nga fshati Polac dhe Bajram Shabani nga fshati Dashec, i cili, i vetmi, ka mbijetuar pa plagosje.

4. Vërboc, komuna e Glllogocit

Në orët e hershme të mungesit të datës 30.04.1999, forca të fuqishme të AJ/MPB-së e kanë rrethuar dhe e kanë filluar granatimin nga të gjitha anët të fshatit Vërboc. Mbi 6.000 shqiptarë të fshatit Vërboc dhe të fshatrave për rreth të komunës së Glllogocit, dhe të Skenderajt, të cilët ishin strehuar aty në ditët paraprake, në panik i kishin braktisur shtëpitë dhe fshatin. Kishin ikur në pyjet për rreth. Pas hyrjes në fshatin e braktisur dhe djegies së shtëpive dhe të objekteve të tjera të tij, forcat serbe policore-ushtarake kanë vazhduar me kërkimin e shqiptarëve të zhvendosur. Tërë ditën kanë hyrë nëpër shtëpi, i kanë zbuluar dhe i kanë vrarë shqiptarët. Me qëllim që t'i nxjerrin nga vendet e fshehura, e kanë djegur pyllin. I kanë ndarë gratë dhe fëmijët, duke i tubuar në grupe më të mëdha, dhe i kanë dërguar në qytetin e Glllogocit, e pastaj, në karvane, i kanë dëbuar për në Maqedoni, kurse shumë prej tyre edhe në Shqipëri. Në ndjekje e sipër, forcat serbe i kanë vrarë 92 shqiptarë nga fshati Vërboc dhe fshatrat për rreth.²⁰

11

Haziri (22.09.1978), nga fshati Krasimirovc, 97) Hashim (Shaqir) Uka (02.09.1937), nga fshati Gradicë, 98) Jahir (Bajram) Sheqiri (26.06.1947), nga fshati Plluzhinë, 98) Muharrem (Sylejman) Rexhepi (04.10.1934), 99) Ymer (Hasan) Ahmeti (17.05.1948), të dytë nga fshati Preloc.

- 19 Baza e të dhënave të FDH: 6 shqiptarë të Kosovës, të cilët për herë të fundit janë parë të gjallë me datën 1. 05. 1999. Te Shavarinat: 1) Nuredin (Avdullah) Dvorani (28.09.1982), 2) Ymer (Fazli) Dvorani (02.06.1957), të dytë nga fshati Tërstenik, 3) Florin (Selman) Istogu (04.06.1963), nga fshati Poluzhë, 4) Beqir (Ahmet) Sejdiu (01.02.1945), nga fshati Likoshan, 5) Selman (Jonuz) Sejdiu (01.02.1937), nga fshati Preloc, 6) Rrahman (Haxhi) Topilla (25.10.1966), nga fshati Gllanasellë.
- 20 Baza e të dhënave të FDH: 1) Zenel (Islam) Bajrami (01.01.1943), nga fshati Baks, 2) Halil (Nasuf) Smajli (01.02.1965), 3) Ismet (Sadik) Rama (11.07.1974) dhe 4) Isuf (Imer) Ferati (24.07.1956), të tretë nga fshati Qirez, 5) Baki (Shefqet) Hoxha (20.10.1970), 6) Ibrahim (Ismail) Hoxha (14.02.1928) dhe 7) Sherif (Fejzullah) Jetullahu (13.06.1953), të tretë nga fshati Domanek, 8) Adem (Sefer) Bunjaku (11.04.1948), 9) Avdyl (Daut) Nika (01.01.1931), 10) Bedri (Murat) Bunjaku (27.02.1953), 11) Hasan (Brahim) Krasniqi (06.10.1934), 12) Hisen (Sadik) Krasniqi (21.05.1964), 13) Kadri (Idriz) Nika (15.01.1966), 14) Mehdi (Salih) Krasniqi (16.09.1956), 15) Mexhit (Hazir) Nika (02.01.1979), 16) Nexhmedin (Avdullah) Nika (27.03.1974), 17) Shefqet (Hazir) Nika (22.12.1962), 18) Sylejman (Islam) Krasniqi (03.12.1963) dhe 19) Zeqir (Hetem) Topilla (19.12.1977), të dymbëdhjetët nga fshati Gllanasellë, 20) Rexhep (Ymer) Elshani (17.03.1941), nga fshati Gllobar, 21) Bekim (Hamze) Elezi (18.05.1972) dhe 22) Ismet (Hamze) Elezi (12.09.1964), të dytë



5. Baks, komuna e Skenderajt

Në orët e hershme të mëngjesit të datë 30.04.1999, pjesëtarët e AJ/ MPB-së pothuajse nga të gjitha anët e kanë rrethuar fshatin Dashec të komunës së Skenderajt. Banorët e fshatit, gra, fëmijë dhe të rritur, duke i bartur njerëzit e pafuqishëm, në panik kanë ikur në pyjet për rreth dhe në bjeshkët në zonën e fshatit Vrboc e, pastaj, në zonën e fshatit Shtuticë. Në një kanal-zonë, të ngjeshur njëri me tjetrin, janë fshehur 38 shqiptar të paarmatosur, kryesisht nga fshati Dashec, midis të cilëve edhe Faton (Bajram) Shabani (6.06.1980), Behxhet (Deli) Shabani (17.06.1972), Naser (Deli) Shabani (01.10.1960) dhe Bajram Shabani. Në mesin e tyre ka pasur edhe të ndjekur nga fshatrat e tjera, midis të cilëve edhe Rahim Ferizi, Nazif Ferizi, Driton Ferizi dhe Ymer Rexha, të gjithë nga fshati Baks. Shpejt, në afërsi prej rreth 40 metrash, deri te kanali ka arritur një tanks dhe kamion, nga i cili ka zbritur një grup i ushtarëve të AJ. Ushtarët, duke bërë titur “ja terroristët, vritni terroristët”, me rafalë plumbash kanë shtënë në grupin e shqiptarëve dhe në vend e kanë mbytur Ymer Rexhën nga fshati Baks. Të mbijetuarit, pasi që i kanë rrahur, i kanë kontrolluar dhe ua kanë marrë paratë, stolitë dhe të gjitha gjërat e tjera sadopak të çmueshme dhe, nën kërcënimin e armëve, i kanë

12

nga Glogoci, 23) Shefqet (Rrahim) Hysenaj (28.11.1967), nga Obria e Epërme, 24) Hamdi (Miftar) Ademi (14.12.1940) dhe 25) Zeqir (Ali) Shabani (01.01.1930), të dytë nga fshati Kozhicë, 26) Xhevdet (Imer) Shala (27.11.1983) nga fshati Krajkovë, 27) Ramadan (Ali) Aliqkaj (26.10.1933) nga fshati Llaushë, 28) Ilaz (Smail) Smajli (01.12.1950) nga fshati Likoshan, 29) Bajram (Mehmet) Aliu (01.01.1968) nga fshati Likoc, 30) Sefer (Istref) Gjinovci (01.01.1951) dhe 31) Selman (Istref) Gjinovci (01.01.1939), të dytë nga fshati Makërmal, 32) Jahir (Bajram) Osmani (01.01.1948) nga fshati Plluzhinë, 33) Muhamet (Rrahman) Haxhiu (15.12.1964) nga fshati Poklek, 34) Ibush (Shefqet) Istogu (19.05.1930) dhe 35) Zene (Shefqet) Istogu (13.01.1937), të dytë nga fshati Polluzhë, 36) Dibran (Ahmet) Kabashi (01.05.1981), 37) Ekrem (Latif) Kerolli (25.03.1981), të dytë nga fshati Polac, 38) Naser (Liman) Sejdiu (10.04.1972) nga fshati Preloc, 39) Bastri (Sadri) Deliu (30.05.1981) nga fshati Rezallë, 40) Agim (Sadri) Dervishi (01.01.1960) dhe 41) Besim (Fazli) Muzhaku (01.01.1976), të dytë nga fshati Çikatovë e Vjëtër, 42) Lulzim (Ahmet) Tahiri (18.06.1967) nga fshati Tërdec, 43) Ferat (Xhafer) Dvorani (02.06.1968), 44) Imer (Fazli) Dvorani (02.06.1957) dhe 45) Lumni (Idriz) Dvorani (08.04.1978), të tretë nga fshati Tërtstenik, 46) Adem (Shaban) Krelani (07.11.1974), 47) Ahmet (Jashar) Dobra (12.02.1937), 48) Ahmet (Ilmi) Istogu (19.04.1964), 49) Azem (Ramadan) Kastrati (27.12.1932), 50) Behlul (Avdi) Prokshi (02.05.1945), 51) Beqir (Hysen) Kastrati (05.05.1952), 52) Burim (Murat) Gllareva (01.01.1981), 53) Demir (Rexhep) Prokshi (13.06.1971), 54) Fahri (Benxhet) Gllareva (07.02.1974), 55) Florim (Bali) Gllareva (04.02.1967), 56) Haki (Behlul) Prokshi (14.08.1974), 57) Halil (Hysen) Gllareva (02.03.1969), 58) Halim (Qamil) Gashi (01.01.1930), 59) Ibrahim (Mehmet) Kastrati (01.02.1969), 60) Ibush (Rexhep) Gllareva (01.01.1940), 61) Ibush (Habib) Shala (03.07.1967), 62) Idriz (Adem) Gllareva (01.01.1930), 63) Islam () Kastrati (), 64) Jahir (Hajrush) Gllareva (01.01.1955), 65) Luan (Selim) Kastrati (18.09.1970), 66) Mehdi (Kadri) Gllareva (15.03.1965), 67) Milaim (Ilmi) Istogu (02.01.1973), 68) Muhamet (Osman) Shala (30.03.1955), 69) Muhamet (Brahim) Tafaleci (09.08.1969), 70) Murat (Idriz) Gllareva (01.01.1958), 71) Mustafe (Xheladin) Shala (01.01.1931), 72) Nexhmedin (Salih) Gllareva (02.06.1967), 73) Osman (Adem) Gllareva (01.02.1938), 74) Osman (Hasan) Kastrati (15.06.1944), 75) Ramadan (Rizah) Gllareva (01.01.1950), 76) Ramadan (Behram) Rukiqi (01.01.1934), 77) Ramadan (Xhafer) Shala (30.04.1979), 78) Rehxe (Sefer) Tafaleci (25.05.1981), 79) Remzi (Rame) Gllareva (04.09.1956), 80) Rexhep (Muhamet) Kastrati (07.08.1980), 81) Safet (Idriz) Gllareva (01.01.1965), 82) Selman (Beqir) Gashi (21.02.1940), 83) Shaip (Smajl) Gllareva (31.12.1963), 84) Sinan (Halim) Gashi (08.04.1955), 85) Smail (Beqir) Gashi (27.12.1947), 86) Smajl (Rame) Gllareva (01.01.1936), 87) Sylejman (Fevzi) Gllareva (26.04.1980), 88) Tahir (Mursel) Prokshi (18.12.1946), 89) Valon (Imer) Rukiqi (01.01.1974), 90) Vehbi (Kadri) Gllareva (02.03.1969), 91) Ymer (Jetullah) Zhushi (24.09.1964) i 92) Zeqir (Shaqir) Gashi (07.02.1951), të 47 viktimat nga fshati Vrboc.



dëbuar drejt fshatit Baks. Në fshatin Baks, një grup i ushtarëve, të cilin e udhëhiqte ushtari Milija, me mbiemër të panjohur, me urdhrin e tij, i ka vrarë tetë shqiptarë të Kosovës. Kur kanë arritur, pjesëtarët e AJ/MPB-së i kanë rreshtuar dhe pushkatuar të tetët, para syve të shumë shqiptarëve të zënë rob. Me datën 3.05.1999, fshatarët i kanë varrosur trupat e tyre jo larg nga vendi i pushkatimit.²¹

6. Studime e Epërme, komuna e Vushtrrisë

Fshatarët nga fshati Studime e Epërme, rreth orës 4:00 të datës 31.05.1999, i kanë shqetësuar dhe i kanë frikësuar dy detonacione jashtëzakonisht të fuqishme. Shpejt e kanë kuptuar se ato janë dy aero-bomba të NATO-s të hedhura në kazermën e vjetër ushtarake të AJ në Vushtrri. Shpejt pas kësaj, forcat e artillerisë dhe të minahedhësve të br. 37 mtr., kanë filluar granatimin. Për më pak se sa gjysmë ore, policët e PPJ, të ndarë në grupe prej 2-3 policësh, kanë hyrë në fshatrat shqiptare. I kanë rrahur dhe i kanë frikësuar familjarët, ua kanë rrëmbyer paratë, stolitë dhe gjërat e tjera të çmueshme, e pastaj i kanë hedhur nga shtëpitë dhe i kanë ndjekur nga fshati. Me këtë rast, policët e PPJ dhe policët e formacioneve të rregullta të MPB-së së Serbisë i kanë vrarë me dhjetëra shqiptarë, midis të cilëve edhe 12 anëtarë të familjes Gerxhaliu: Xhemajl Gerxhaliu, Seladin Gerxhaliu dhe djalin e tij Shaban Gerxhaliu, bashkëshorten e Seladinit, Fexhrije Gerxhaliu (1954), dhe pesë fëmijët e tyre të moshës jomadhore - Muharrem Gerxhaliu (1985), Mexhita Gerxhaliu (1987), Abdurrahman Gerxhaliu (1989), Mybera Gerxhaliu (1988), Sabahudin Gerxhaliu (1992), pastaj Salihe Gerxhaliu (e lindur në vitin 1918), Sofije Gerxhaliu (e lindur në vitin 1963) dhe Safet Gerxhaliu (i lindur në vitin 1988), të gjithë nga fshati Studime e Epërme. Kushërinjtë e 12 të vrarëve, po atë ditë i kanë mbledhur trupat e tyre dhe të gjithë i kanë varrosur në varrezën e tyre familjare²².

13

7. Izbicë, komuna e Skenderajt

Me datën 27.03.1999, forcat e AJ e kanë granatuar fshatin Izbicë. Së paku 4.500 banorë dhe persona të zhvendosur kanë kërkuar strehimin e tyre në një fushë në pjesën skajore të Izbicës. Me datën 28. 03.1999, pjesëtarët e PPJ i kanë rrethuar fshatarët e pastaj iu janë afruar atyre dhe ua kanë kërkuar paratë. Sipas dëshmimeve të tre dëshmitarëve okular, Milazim Thaçit, Mustafë Dragës dhe Sadik Januzit, të cilët GJNPJ (i kishte pranuar si të besueshëm), pasi që njerëzve ua kishte marrë paratë, policët i kanë ndarë meshkujt nga gratë. Pas numërimit të meshkujve të ndarë, kryesisht të vjetër, pjesëtarët e PPJ i kanë ndarë në dy grupe. Thaçi ka qenë në grupin më të vogël, të cilin e përbënin 33 meshkuj, derisa Draga dhe Januzi kanë

21 Baza e të dhënave të FDH: dy deklarata të B.S, FHP-14920 dhe FDH-20291: „Tetë shqiptarë janë vrarë sipas urdhrin të ushtarit Milije: 1) Halit (Qerim) Haliti (01.05.1946) dhe 2) Mehmet (Sherif) Mehmeti (25.02.1946), të dytë nga fshati Shterubullovi; 3) Feti (Daut) Sofi (19.10.1959) nga Glogoci; 4) Fidaim (Kamer) Zena (06.03.1969) nga fshati Shtuticë; 5) Bexhet (Deli) Shabani (17.06.1972) nga fshati Dashec; 6) Rrahim (Habib) Ferizi (28.09.1981) dhe 7) Nazif (Habib) Ferizi (08.09.1984), të dytë nga fshati Qirez dhe 8) Driton (Hajriz) Bajrami (1.10.1983), nga fshati Baks.“

22 GJNPJ, lënda nr. IT-05-87-T, *Prokurori kundër Millutinoviçit dhe të tjerëve*, lëndë e dëshmisë me numër P02257, Baza e të dhënave e FDH: deklaratë e F. B, FDH-2871; deklaratë e F. G, FDH-20639; deklaratë e Sh. G, FDH-12467.



qenë në grupin e madh prej 70 meshkujsh. Grupi i Thaçit, nën përcjelljen e një polici, është dërguar deri te një kanal, rreth 200 metra larg një fushnaje. Thaçi ka qenë i pari në atë grup. Të gjithë ishin drejtuar nga pylli, i largët vetëm disa metra. Pjesëtarët e PPJ kanë hapur zjarr në meshkujt e rreshtuar shqiptar. Pushkatimit, pos Thaçit²³, i kanë shpëtuar edhe dy të tjerë. Grupi i dytë i meshkujve, në të cilin ka qenë Draga dhe Januzi, është dërguar 500 metra më poshtë nga fushnaja e përmendur. Grupin e kanë përcjellë rreth 30 pjesëtarë të PPJ. Draga është ndodhur në mesin e grupit. Me të filluar shtënia, është rrëzuar në tokë dhe një kushëri i tij ka rënë mbi të. Pas përfundimit të të shtënave, Draga, i cili nuk ka qenë i plagosur, ka qëndruar i shtrirë prej 20 deri 30 minuta dhe gjatë asaj kohe ka parë se si ushtarët i kanë djegur shtëpitë në Izbicë. Januzi e ka përshkruar të njëjtën ngjarje në deklaratën e tij prej dëshmitari dhe e ka shpjeguar se ka mbetur gjallë falë faktit se ka rënë në tokë para se të qëllohej dhe edhe për arsye se mbi të kishin rënë tre trupa.²⁴ Draga e ka parë kur janë vrarë dy pleq dhe dy plaka, ngaqë nuk mund të ecnin. Njëra nga to ka qenë plaka shtatëdhjetë vjeçare Zojë Osmani, e cila është gjetur e djegur në rimorkion e traktorit.

Në bazë të raporteve mjeko-ligjore nga lokacioni i varrezës masive, regjistrin të personave të zhdukur të Zyrës së UNMIK-ut për persona të zhdukur (OMPF), dëshmime dhe regjistrin të cilin ia ka dorëzuar gjykatës Liri Loshi, numri i viktimave në Izbicë, i cili lidhet me sulmin e AJ/MPB-së të datës 28.03.1999, ka qenë 119.²⁵ Edhe disa trupa janë gjetur në lokacionet e tjera në Izbicë. Meshkujt e vrarë kryesisht kanë qenë më të vjetër, të moshës mesatare midis 60 dhe 70 vjeçare. Dëshmitë e kombinuara të tre të të mbijetuarve, të cilët kanë dëshmuar në GJNPJ, tregojnë se pushkatimit i kanë mbijetuar gjithsejtë 14 meshkuj.²⁶ Pjesëtarët e UÇK-së trupat e të vrarëve i kanë varrosur në 127 varreza, fare afër fushnajës, ku njerëzit e shpërndarë ishin tubuar para ardhjes së forcave serbe. Midis 127 trupave të varrosur, kanë qenë edhe dy ushtarë të UÇK-së, Hamdi (Ajet) Doqi (15.05.1955) nga fshati Kërnice dhe Sami (Jashar) Loshi (1974) nga fshati Padalishtë.²⁷ Pas kthimit në Izbicë, fshatarët nuk i kanë gjetur as varret e as trupat. Forcat e AJ/MPB-së i kanë zhvendosur trupat para hyrjes së forcave të NATO-s në Kosovë. Shumica e trupave kanë qenë të zhvendosur në varrezat në Mitrovicë (Kosovë), derisa një numër është dërguar në Serbi dhe është varrosur në varreza të fshehta, në terren policor në Petrovo Selo.

Shumë urdhra dhe raporte të luftës të AJ, që e përbëjnë regjistrin e lëndës IT-05-87-T, vërtetojnë se në kohën e vrasjeve në fshatin Izbicë është kryer aksioni i përbashkët i AJ/MPB-së. Kanë qenë brigada 37 dhe ajo 125 ato forcat e AJ, të cilat kanë marrë pjesë operacionin e shkatërrimit të “forcave terroriste-shqiptare” në komunën e Skenderajt. Në aksion kanë marrë pjesë shtatë çeta të PPJ, prej të cilave dy e kanë pasur për detyrë që aktivitetet e tyre t'i koordinojnë me brigadën e motorizuar 37. Dikoviqi para gjykatës së pari ka pohuar se njësitë e tij asnjëherë nuk kanë hasur në civilë në zonën e Izbicës²⁸, kurse,

23 GJNPJ, lënda nr. IT-05-87-T, *Prokurori kundër Millutinoviqit dhe të tjerëve*, lëndë e dëshmisë me numër P2525, deklaratë e dëshmitarit Milazim Thaçi.

24 ²⁵ GJNPJ, lënda nr. IT-05-87-T, *Prokurori kundër Millutinoviqit dhe të tjerëve*, lëndë e dëshmisë me numër P2525, deklaratë e dëshmitarit Sadik Januzi.

25 GJNPJ, lënda nr. IT-05-87-T, *Prokurori kundër Millutinoviqit dhe të tjerëve*, vendim gjyqësor, f. 228-265.

26 GJNPJ, lënda nr. IT-05-87-T, *Prokurori kundër Millutinoviqit dhe të tjerëve*, vendim gjyqësor, f. 211.

27 GJNPJ, lënda nr. IT-05-87-T, *Prokurori kundër Millutinoviqit dhe të tjerëve*, lëndë e dëshmisë me numër P02436, deklaratë e dëshmitarit Liri Loshit.

28 GJNPJ, lënda nr. IT-05-87-T, *Prokurori kundër Millutinoviqit dhe të tjerëve*, transkripte të dëshmisë së



megjithëkëtë, më vonë ka pohuar se në vet Izbicë “i kanë ndërprerë [...]veprimet, i kanë ndarë njerëzit”, dhe ka shtuar se atëherë para tij është gjendur njëfarë njësie e MPB-së.²⁹ Më vonë prapë e ka pohuar atë kontakt me civilët.³⁰

8. Përfundimet relevante nga gjykimet lidhur me lëndën IT-05-87-T, *Prokurori kundër Millutinoviçit dhe të tjerëve*

Paragrafi 562. “Në lidhje me akuzat e lidhura me keqtrajtimit seksuale në fshatin Qirez diku nga mesi i prillit të vitit 1999, dëshmi të drejtpërdrejta kanë dhënë dy dëshmitarë okular, përkatësisht Xhevahire Rrahmani dhe dëshmitarja K24. Dëshmitë e saj në pjesën më të madhe nuk janë kundërshtuar dhe ato, pos disa kundërthënieve në pikëpamje të identifikimit të uniformave të kryerësve të atyre veprave penale, marrë në përgjithësi, përputhen. Trupi gjykues po ashtu ka pranuar informatat e caktuara mjeko-ligjore relevante për fatet e disa prej viktimave të përmendura, të cilat përputhen me dëshmitë e dëshmitareve Rrahmani dhe K24. Trupi gjykues, së këndejmi, ka pranuar dëshmitë e tyre.”

Paragrafi 564. –“Trupi gjykues ka dëgjuar dëshmitë edhe të një numri të dëshmitarëve, të cilët kanë qenë në formacionet e AJ dhe MPB-së, siç janë Ljubisha Dikoviçi, Slagjan Pantiçi, (Sladan Pantić), Petar Damjanac, Nebojsa Bogunoviçi (Nebojša Bogunović) dhe Dragan Zhivanoviçi (Dragan Živanović), dëshmitë e të cilëve i kundërvihen aspekteve të veçanta të dëshmimeve të dëshmitarëve të prokurorisë në lidhje me Skenderajn. Një pjesë e dëshmimeve të tyre, të cilat konsiderohen të besueshme, paraqiten në tekstin e mëtejme.”

Paragrafi 568. “Para trupit gjykues janë sjellë dëshmi edhe për zhvendosjen dhe lëvizjen e forcave të RSJ/Serbisë në komunën e Skenderajt para bombardimit të NATO-s. Përforcimet me PPJ nga Serbia kanë qenë të stacionuara në Fabrikën e ‘Feroniklit’ në Glllogoc nga muaji maj i vitit 1998, kurse forcat e AJ dhe MPB-së kanë qenë të përqendruara jo larg nga fshati Polac, të vendosura në afërsi të vendit Skenderaj. Sipas fjalëve të të akuzuarit Llazareviç (Lazarevića), operacionet e përbashkëta të AJ- dhe MPB-së në vitin 1999 kanë qenë dukshëm me një vëllim më të vogël se sa në vitin 1998 dhe janë zhvilluar në “vatrat” e UÇK-së, siç janë zonat e Drenicës dhe zona e gjerë e malit Çiçavicë. Në ato aksione, MPB-ja drejtpërsëdrejti është përlëshur me UÇK-në, kurse AJ i ka përkrahur me “lëvizjet, manovrat dhe zjarrin”.

Paragrafi 569. “Ljubisha Dikoviçi, i cili ka qenë komandant i brigadës 137 të motorizuar të AJ dhe zona e përgjegjësishë së të cilit e ka përfshirë Drenicën, ka dëshmuar se një grup luftarak nga brigada e tij, Grupi luftarak 37, atje ka arritur me datën 7.03.1999, derisa pjesa e mbetur e brigadës, e përforcuar me rreth 100-150 vullnetarë, i është bashkëngjitur në fillim të muajit prill.”

Ljubisha Dikoviçi të datës 10 dhe 11.12.2007.

29 GJNPJ, lënda nr. IT-05-87-T, *Prokurori kundër Millutinoviçit dhe të tjerëve*, transkripte të dëshmisë së Ljubisha Dikoviçit të datës 11.12.2007.

30 GJNPJ, lënda nr. IT-05-87-T, *Prokurori kundër Millutinoviçit dhe të tjerëve*, transkripte të dëshmisë së Ljubisha Dikoviçit të datës 11.12.2007.



Paragrafi 570. “Dragan Zhivanoviqi, komandant i brigadës 125 të motorizuar, i cili po ashtu në atë kohë ka qenë në atë zonë, ka dëshmuar se në gjysmën e dytë të muajit mars të vitit 1999 janë intensifikuar sulmet e UÇK-së në forcat e AJ në rajonin e Drenicës. Me datën 18.03.1999, i akuzuari Llazareviq e ka sajuar planin e zbatimit të aksionit për thyerjen e UÇK-së në rajon e Drenicës Veriore dhe në Podujevë. Me datën 19.03, Komanda e përbashkët ka dhënë urdhrin, me të cilin njësitë të brigadës 37 të motorizuar iu urdhërohet që, së bashku me njësitë nga brigada 125 e motorizuar dhe njësitë e PPJ nga Mitrovica dhe Peja, të sulmojnë UÇK-në përgjatë drejtimit të fshatit Mikushnicë, Prekaz i Ulët, Polac, rreth tri kilometra larg prej Qirezit. Siç qëndron edhe në raportin operativ ditor të Dikoviqit të datës 20. 03.1999, njësitë e brigadës 37 të motorizuar “angazhohen në thyerjen e terrorizmit në drejtimin: s. Balincë-s. Ljubovc-s. Polac [...] sipas urdhrit të komandantit të KPr “. Forcat e përbashkëta kanë arritur në atë zonë diku rreth datës 20 ose 21 mars të vitit 1999. Atëherë nuk kanë parë civilë. Në operacionin e prishjes së istikameve të UÇK-së dhe të pozicioneve të tjera të vërtetuara, janë shfrytëzuar tankset. Njësitë e brigadës 125 të motorizuar janë dashur të formojë një vend komandimi në fabrikën e municionit në Skenderaj dhe në aksionin e koordinuar të brigadës 37 të motorizuar dhe forcave të MPB-së është dashur të bëjnë zhbllokimin e drejtimit Klinë-Skenderaj dhe vendit Skenderaj. Pastaj është dashur të vazhdojnë aksionin dhe të shkatërrojnë forcat e UÇK-së në zonën e Prekazit të Ulët dhe Polacit.”

Paragrafi 594. “Shumë urdhra dhe raporte të luftës të AJ të përvetësuar në regjistër vërtetojnë se në kohën e vrasjeve në Izbicë të komunës së Skenderajt është kryer aksioni i përbashkët i AJ/MPB-së. Me datën 22 mars të vitit 1999, Komanda e përbashkët e ka urdhruar “vendimin për shkatërrim të “FTSH” në rajonin e Drenicës së Ulët. “Vendimi parashihte sulmin në pjesën lindore të Skenderajt, në drejtim të fshatit Polac-Trstenik-Prellovc-Likoshan. Forca të AJ, të cilat kanë marrë pjesë në atë sulm në komunën e Skënderajt, kanë qenë brigada e 37 e motorizuar dhe ajo 125. Në aksion kanë marrë pjesë edhe shtatë çeta të PPJ, prej të cilave dy është dashur të koordinohen me brigadën 137 të motorizuar 137.”

Paragrafi 595. “Me datën 24 mars të vitit 1999, Komanda e përbashkët ua ka dhënë edhe një urdhër njësitë të AJ që ato t’i ofrojnë mbështetje MPB-së në shkatërrimin e “ ‘FTSH’ në rajonin e Drenicës (në tekstin e mëtejme: Operacioni Drenica). Sipas atij urdhri, qëllimi ka qenë që të bllokohen, FTSH’ në rajonin e gjerë të shumë fshatrave, duke përfshirë këtu edhe fshatrat Kllodernicë, Turiqevc, Voqjak dhe Broqnë. Dikoviqi ka vepruar sipas këtij urdhri, duke e zhvendosur vendin e tij të komandimit në zonën e Rudnikut, fshat ky në veriperëndim të Skenderajt. Ai, po ashtu, grupin e tij luftarak e ka angazhuar përgjatë drejtimit të fshatrave Rudnik, Vitak, Klodernica, Voqjak dhe Broqnë, siç është shënuar në raportet ditore operative dhe urdhrat e brigadës. Grupi luftarak ka qenë në atë rajon disa ditë dhe është ndalur në një vend mbi fshatin Voqjak. Dikoviqi ka dëshmuar se grupi luftarak është përballur me UÇK-në në zonën e përmendur duke i ofruar mbështetje MPB-së dhe sigurisht se ka shfrytëzuar tanket me qëllim që të shkatërrojë pozicionet e zjarrit të cilat i kishte formuar UÇK-ja në drejtim të sulmit.”

Paragrafi 598. “Në raportin e datës 28. mars po ashtu është shënuar: Në veprimet e mëtejme



në rajonin s-Voqnjak presim ikje të më shumë mijëra civilëve. Për këtë arsye Dikoviqi ka kërkuar udhëzime për sjelljet me të njëjtët, sepse njësia nuk ka fuqi dhe mjete për bllokimin e të ikurve dhe implementim jashtë zonës b/d.

Ka shpjeguar se thjesht ka sjellë mundësinë, e cila i është dukur reale kur kihet parasysh numri i madh i forcave të UÇK-së në rajonin në fjalë dhe strategjia e tyre e shfrytëzimit të civilëve si mbrojtje. Në bazë të kësaj kërkesë, është dërguar një oficer nga Korpusi i Prishtinës, i cili i ka thënë Dikoviqit që, në rast se paraqiten civilët, njësia e tij duhet t'i ndal veprimet e saj dhe t'i dërgoj në drejtim të sigurt në ndonjë rajon të sigurt. Kjo do të ishte nën përgjegjësinë e MPB-së, që edhe do t'iu ndihmonte civilëve. Në pyetjen nëse kjo ka ndodhur ndonjëherë, Dikoviqi së pari ka thënë se grupi i tij luftarak kurrë nuk ka hasur në civilë në atë rajon. Megjithatë, më vonë ka deklaruar **se në vet Izbicën “kanë ndërprerë [...] veprimet, i kanë ndarë njerëzit”** dhe ka shtuar se ‘atëherë para tij është ndodhur njëfarë njësie e MPB-së. Më vonë prapë ka pohuar atë kontakt me civilët duke thënë se e ka ndalur aksionin për arsye se forcat ishin takuar me civilët në rajonin e Izbicës dhe se për këtë arsye është kthyer mbrapsht në drejtim të Skenderajt në vend se të vazhdonte drejt Brojës, siç ka qenë e paraparë.”

Paragrafi 601. “Dikoviqit, i cili me njësitë e tij ka qenë në rajonin e gjerë të Izbicës me datën 27 dhe 28 mars të vitit 1999, i është shtruar pyetja nëse ai ose forcat e tij kanë marrë pjesë ndonjëherë në heqjen e trupave nga varrezat në Izbicë dhe nëse ai ndonjëherë ka marrë pjesë në ndonjë hetim lidhur me këtë. Ai është përgjigjur se nuk din për varrezën masive në Izbicë, se asnjëherë nuk ka marrë pjesë në veprimet hetuese në lidhje me farë varreze masive dhe se asnjëherë nuk ka qenë i autorizuar për këtë”

Paragrafi 605. “Trupit gjykues i është dorëzuar një material vëllimor mjeko-ligjor relevant për identitetin e personave të vrarë në Izbicë. Për shkak të heqjes së trupave nga varrezat e Izbicës, këto dëshmi janë përgatitur në kohë të ndryshme dhe në vende të ndryshme. Raportet po ashtu tregojnë se një numër i caktuar i viktimave prej 118 nga Izbica të përmendur në Kontributin F, pos njëres e cila nuk është përmendur, kanë përfunduar në Petrovo Selo, derisa të tjerat janë varrosur në varreza në Mitrovicë. Analiza konkrete e të gjitha dëshmive të lidhura me secilën viktimitë të veçantë të përmendur mund të gjenden në Shtesën A të Gjyqimit.”

Paragrafi 614. “Një numër më i madh i viktimave nga Izbica është varrosur në Mitrovicë (Kosovë), kurse jo në Petrovo Selo. Jon Sterenberg, shef i Repartit MKNL për zhvarrosjen dhe për ekzaminimin, ka dëshmuar se MKNL po ashtu ka bërë analizën e AND-s me qëllim të identifikimit të mbetjeve mortore të personave të varrosur në Kosovë. MKNL-së mostrat e mbetjeve ia ka dorëzuar UNMIK-u me qëllim që t'i mundësohet që, për qëllime identifikimi, t'a krahasojnë AND-në me mostrat e të afërmeve. Në bazë të krahasimit të mostrave, janë identifikuar shumë viktima të Izbicës.

Paragrafi 622. “Dëshmitaret, përkatësisht Xhevahire Rrahmani dhe dëshmirarja K24, kanë sjellë të gjitha dëshmi të drejtpërdrejta në lidhje me akuzat për keqpërdorim seksual në fshatin Qirez diku nga mesi i muajit prill të vitit 1999.”



Paragrafi 633. “Herën e fundit kur i kanë marrë pesë vajza, ushtarët me tel e kanë ngjuar derën e stallës. Së shpejti ka ardhur ai ushtari flokëverdhtë dhe i ka thënë Miridije Dibranit, Tahire Shalakut (nëna e Rrahmanëvet) dhe Fahrije Ademit të ecin me ta. Kanë bërë ashtu siç iu është thënë, dyert pastaj janë mbyllur dhe dëshmitarja K24 dhe Rrahmani i kanë dëgjuar tri të shtëna. Asnjëra prej tetë grave kurrë më nuk është parë e gjallë. Rrahmani ka dëshmuar se pesëmbëdhjetë minuta më vonë, një ushtar, të cilin më parë nuk e kishin parë dhe me uniformë të verdhë, ka ardhur në stallë dhe iu ka thënë grave që të kthehen në Kozhicë.”

Paragrafi 640 “(...) Me datën 21 prill, sipas një raporti tjetër, të cilin Dikoviqi ia kishte dërguar Komandës së Korpusit të Prishtinës, batalioni i 3 i motorizuar i brigadës 37 të motorizuar është gjendur në zonën e Qirezit. Në raport po ashtu përmendet fakti se forcat e MPB-së në atë rajon nuk kanë marrë pjesë në asnjë aksion dhe se nuk kanë ndërmarrë asgjë që të kontrollojnë territorin, por pjesëtarët e saj kryesisht janë “marrë me therrjen e bagëtisë dhe mbledhjen e presë së luftës.”

Paragrafi 644. “Dikoviqi ka pranuar se, përkundër të gjitha masave të ndërmarra nga ai, disa ushtarë të tij, prapëseprapë, kanë kryer krime në gjysmën e parë të prillit. Evidenca e Korpusit të Prishtinës tregon se nga data 10 deri më 15 prill, shumë persona nga njësitë e Dikoviqit kanë marrë pjesë në vrasjen e meshkujve shqiptarë kosovar në zonën e Klinës së Epërme, kurse kufomat e të vvarëve i kane hedhur në bunare. Evidenca po ashtu tregon se një njeri tjetër, vullnetar nga njësia e Dikoviqit, në fshatin Krasimirofc e në rrethinën e tij, jo larg prej Qirezit, ka vvarë disa shqiptarë dhe i ka nxjerrë gratë nga kolonat e të zhvendosurve.”





Fondi për të Drejtën Humanitare

Shtojcë

HLIndexOut: 019-3185-2
Beograd, 09.02.2012.

Shtojca përmban ekstraktet nga dokumentet në dispozicion të publikut të UJ-së i cili më tej vërteton pretendimet e FDH-së të paraqitura në dosjen e Lubisha Dinkoviçit, të publikuar më datën 23.01.2012 për praninë e njësisë të brigadës së 37 të motorizuar të UJ-së në rajonin e Drenicës të Kosovës, ku kanë ndodhur vrasjet masive të civilëve shqiptarë dhe shkelje të tjera të rënda të drejtave humanitare ndërkombëtare.

Një pjesë e shtojcës është raporti luftarak i rregullt i brigadës së 37 të motorizuar, daljes së njësisë me datën 27.03.1999, në tt.692, të cilin viktimat e mbijetuara e identifikojnë si Fusha Vrogodoll/Vragodol ku ushtarët vranë 22 burra shqiptarë prej të cilëve katër mbijetuan.

Përveç kësaj, në shtojcë janë raportet e nënshkruara nga komandantit i njësitit 37 të motorizuar mbi vendosjen e kontrollit mbi civilët shqiptarë në fshatrat e komunës së Glllogocit/Glogovac dhe Skënderajit/Srbica në qytetet e cekura pasi mijëra shqiptarë janë dëbuar dhe të paktën 250 të vrarë nga kjo zona edhe pse nuk kanë marr pjesë në luftime. Plani “Rrufeja 98”, urdhëri i tretë i Armatës së UJ-së nga i cili është gjithashtu një pjesë e shtojcës në tërësi në dispozicion në faqen e internetit të FDH-së dhe në bazën e të dhënave publike të TPNJ tregon se disa grupe luftarake të brigadës 37 të motorizuar që në korrik të vitit 1998 kanë marr detyra shumë specifike „shkatërrimi i FVT dhe forcave të armatosura të rebeluar në KeM.

Që Lubisha Dikoviç nuk ka qenë një oficer shembullor as në raport me ushtarët e tij, gjë që nuk e rekomandon për shefin e Shtabit flet dokumenti i Komandës së Korpusit të Prishtinës në të cilin gjenerali i dënuar Vladimir Llazareviç, komandant i KP-së me rastin e vdekjes së dy ushtarv të njësisë së brigadës 37 të motorizuar me datën 29.04.1999 në sulmin ajror të NATO-s paralajmëron Dikoviçin që shkak i vdekjes ishte jodisiplina dhe mospërfillja e vazhdueshme e urdhrave të „komandës së pandërprerë”.

Komandanti i brigadës së 37 të motorizuar ka ditur (do duhej ta dinte) që shpartallimi i FSHT është bërë me granatimet e fshatrave, dëbimin e popullatës, me grabitje, përdhunime dhe vrasje të paligjshme të civilëve shqiptarë. Krimet janë përsëritur nga njëri në aksionin tjetër për “shpartallimin dhe shkatërrimin e FSHT.” Për to dhe marrëdhëniet me Komandën e Përbashkët për KeM, Lubisha Dikoviç është dashur të flas pas rënies së Sllobodan

Millosheviqit. Ai këtë nuk e bëri, por si një dëshmitar për mbrojtjen e gjeneralit Llazareviq, në lëndën Prokurori kundër M. Milutinoviç dhe të tjerët e mbrojtji gjeneralin e akuzuar dhe mohoi që ishte në dijeni për krimet dhe varrezat masive në zonën e tij të përgjegjësisë.

1. Përparimi në shërbim

Gradën e majorit të UJ-së e ka fituar në vitin 1994 për meritat në mbrojtjen e atdheut nga “sulmi i ekstremistëve myslimanë në Skelani, Srebrenica dhe Bratunci”, në pozitën e komandantit e batalionit të 16-të kufitar³¹.

Gradën e kolonelit e fiton në vitin 1998 kur Komanda e Armatës së 3-të ka vendosur planin “Rrufeja 98”.

Shef i shtabit të brigadës 37 të motorizuar është emëruar në vitin 1998.

Komandant i brigadës së motorizuar është emëruar më 3 nëntor të vitit 1998³².

Në mënyrë të përshpejtuar është graduar me gradën e kolonelit në fillim të marsit të vitit 1999³³.

20

Në emër të brigadës së 37 të motorizuar ka marrë dekoratën e Heroit të Popullit më 16.06.1999 me vendim të presidentit të RSFJ-së Sllobodan Millosheviq.

Gradën e gjeneral majorit të Ushtrisë së Serbisë e ka marrë në vitin 2005³⁴.

Gradën e gjeneral kolonelit në vitin 2009³⁵.

2. Vrasja e dy ushtarëve të brigadës së 37 të motorizuar

Më 29.04.1999 në mes të orës 15:00 dhe 16:00 në rajonin e fshatit Orllat në sulmin e aviacionit të NATO-s janë vrarë dy pjesëtarë të brigadës së 37-të të motorizuar (Gjorgje Dunjiq dhe Lubinko Gjorgjeviq – identifikimi i identitetit FDH).

Në të njëjtën ditë, komandanti i Korpusit të Prishtinës, gjeneral major Vlladimir Llazareviq

31 Artikulli, Ushtria “Shembull për gjeneratat”, faqe.9-13, 15.07.1999. (TPNJ,IT-05-87:Millutinoviç et al, Document Type: Submission, Date: 05/07/2006).

32 Emisioni „Po, ndoshta jo“, deklarata e Miroslav Llazanjskit, RTS, 26.01.2012.

33 Artikulli „Ushtria“, „Njerëzit e guximshëm të Drenicës, heronjtë e mbrojtjes“, faqe.11-13, 15.07.1999, kapetan Sllobodan Radenkoviç (TPNJ, IT-02-54:Millosheviq, Exhibit P320.106); Artikulli, „Ushtria“, „brigade e 37-të e motorizuar e UJ-së“, faqe.11-13, 15.07.1999. (TPNJ, IT-05-87: Millutinoviç dhe të tjerët, Document Type: Submission, Date: 05/07/2006).

34 Ushtria e Serbisë, faqe e internetit: <http://www.vs.rs/index.php?content=8709fe1d-fdf2-102b-9fa8-28e40361dc2e>

35 Njejte



të shënuar si shumë urgjente i ka dërguar komandës së brigadës të 37-të të motorizuar urdhërin mbi marrjen e masës së përgjegjesisë për rrezikimin e sigurisë së njerëzve dhe njësisë.

„E vlerësoj se shkak i vrasjes së ushtarëve është pasojë e një mosdiscipline të skajshme të një pjese të përbërjes së brigadës së 37-të të motorizuar dhe moszbatimin e urdhërave të mija mbi kontrollën e plotë ndaj të gjitha përbërjeve dhe komandën e pandërprerë të njësive komanduese³⁶.

3. Detyra e brigadës së 37-të të motorizuar e paraparë me planin “Rrufeja 98”³⁷

Sipas dokumentit “Rrufeja 98” të datës 29.07.1998 të cilën e ka nënshkruar komandanti i Armatës së 3-të të UJ-së gjeneral koloneli Dushan Samarxhiq është bërë ndarja e detyrave njësive të korpusit të Prishtinës. Në fazën e parë e gjithë njësia e Korpusit të Prishtinës duke përfshirë grupin luftarak të brigadës së 37 të motorizuar. Ndërsa, është dashur është sigurojë kufirin shtetëror në drejtim në Shqipërisë dhe Maqedonisë, të mbrojë njësitet dhe objektet ushtarake nga veprimi i „DTG“, të sigurojë kalimin e komunikimit për furnizimin e njësive dhe në bashkëveprim me forcat e MPB-së të Serbisë të marrë pjesë në shkatërrimin e “FSHT” në zonën e përgjegjesisë.

4. Detyra e brigadës së 37-të të motorizuar e datës 7.03.1999.

„Në kohë paqe nuk kemi pasur aksione të cilat kanë përfshirë hyrjen në fshatra dhe pastrimin ngaqë këtë e bënte policia ushtarake ndërsa tani ne gjatë lëvizjes është dashur ta bëjmë këtë³⁸.

5. Pjesëmarrja e brigadës së 37-të motorizuar në operacionin e Drenicës

Me datën 22. 03.1999 Komanda e përbashkët për KeM ka lëshuar vendimin për shkatërrimin e “FSHT” në rajonin e Drenicës së Poshtme. Forcat e UJ-së të cilat kanë marrë pjesë në këtë sulm në komunën e Skënderaj/Srbica kanë qenë brigadat e motorizuara 37 dhe 125. Në operacion kanë marrë pjesë shtatë çeta të PJP-së dy nga të cilat ishin në komunikim të drejtëpërdrejtë me brigadën e 37-të të motorizuar. Vendi i komandës fillimisht ishte në Skënderaj/Srbici, e pastaj në fshatin Çikatovë/Čikatovo³⁹.

Me datë 24. 03.1999 komanda e Përbashkët për KeM ka lëshuar edhe një urdhër njësive të UJ-së të ofrojë ndihmë forcave të MPB-së në shkatërrimin e “FSHT” në rajonin e Drenicës.

36 TPNJ, Komanda e Korpusit të Prishtinës, 29.04.1999, Komandant, gjeneral-major Vlladimir Llazareviq; (MKS), IT-05-87:Milutinovic et al, Exhibit 5D00385).

37 TPNJ, Urdhër për shkatërrimin e FVT dhe forcave të armatosura të kryengritura në KeM, Komanda e Armatës së 3-të, DT.nr.6034-7/1, 29.08.1998 (TPNJ, IT-05-87:Milutinovic et al, Exhibit 4D00140).

38 Artikulli „Ushtria“, „Njerëzit e guximshëm të Drenicës, heronjtë e mbrojtjes“, faqe.11-13, 15.07.1999, kapetan Sllobodan Radenkoviq (TPNJ, IT-02-54:Millosheviq, Exhibit P320.106);

39 TPNJ, Komanda e përbashkët për KeM, Vendimi për thyrjen dhe shkatërrimin e FTSH në rajonin e Drenicës së Poshtme (TPNJ, IT-05-87:Milutinovic et al, Exhibit P02031).



Është vendosur që sulmin ndaj "FSHT" ta fillojë në ora 5:00 më 26.03.1999 brigada e 37-të e motorizuar (BG-37 dhe TG-37) ka marrë detyrë që të përkrahë forcat e MPB-së në drejtim të fshatrave Runik/Rudnik -Vitak- Klladërnice/Kladernica – Vojnikë/Voćnjak – Burojë/Broćna.

Komandanti i brigadës së 37-të motorizuar ka vepruar bazuar në atë urdhër duke bartur vendin e saj të komandës në fshatin Rudnik/Runik⁴⁰.

5.1. Aktivitetet e grupës luftarake të brigadës së 37-të të motorizuar në rajonin ndërmjet Izbicë/Izbice dhe Kllodërnice/Kladernice

22

Fshati Runik/Rudnik është sulmuar më 25.03.1999. Banorët e kanë lëshuar fshatin dhe janë fshehur në fshatin fqinj Klladërnice/Kladernicu. Ditën tjetër, më 26. 03.1999 ka filluar shkëmbimi i zjarrit nga drejtimi i kodrës mbi fshat. Fshatarët dhe refugjatët të cilët gjendeshin në fshat e kanë lëshuar fshatin, i kanë lëshuar shtëpitë dhe janë larguar në mal. Para hyrjes në mal, tek përroi, i kanë lënë traktorët. Të ikurit, rreth 500 meshkuj, gra dhe fëmijë, janë fshehur në fushë të rrethuar me dru. Aty kanë kaluar natën. Në mëngjesin e datës 27.03. 1999 kanë dëgjuar të shtëna në afërsi të tyre. Rreth orës 11.00 janë rrethuar nga ushtarët të cilët në gjuhën serbe kanë bërtitur "Dorëzohuni". Para ushtarëve ka dalur Zeqir Mulaj (1939). Është goditur deri sa iu ka spjeguar në gjuhën serbe se të gjithë janë civil. Pastaj e kanë vrarë djalin e tij Arton Mulajn (1982). Për vdekje e kanë goditur Miradije Mulajn (1973). Pastaj kanë ndarë 22 meshkuj në mesin e të cilëve edhe Valonin e mitur të cilët në kolonë i kanë shpjer drejt malit. Pas 10 minutave është shfaqur një aeroplan i NATO-s pas së cilës ushtarët për tre orë rresht i kanë sharë dhe rrahur. Prap kanë urdhëruar lëvizjen duke i dërguar në drejtim të Izbicë/Izbice. Duke shkuar në atë drejtim kanë arritur deri tek traktorët të cilët ata (fshatarët Runik/Rudnika dhe Vitak/Vitka) i kanë lënë afër përroit para hyrjes në mal. Ushtarët i kanë djegur të gjithë traktorët. Në rimorkio e njërit traktor ka qenë i shtrirë Osman Mulaj i cili ishte një i moshuar i pafuqishëm. Pastaj, shqiptarët e arrestuar i kanë dërguar në fushën e Vrogodoll/Vragodol⁴¹.

Deri në ora 15.00 të datës 27.03.1999 njësitë e brigadës së 37-të të motorizuar kanë arritur në linjën tt.628 - tt.715 - 706 - 692. Tt 692 është një fushë në Vrogodoll/Vragodol, në mes të fshatit Izbicë/Izbice dhe Kllodërnice/Kladernice⁴².

Ushtarët i kanë sjellur të burgosurit shqiptarë në fushë ku kanë qenë të vendosur një tank

40 TPNJ, Komanda e përbashkët për KeM, 24.03.1999. Vendimi për përkrahjen e forcave të MPB-së në thyjen dhe shkatërrimin e FTSH në rajonin e Drenicës (TPNJ, IT-05-87:Milutinovic et al, Exhibit P01968).

41 Baza e të dhënave, FDH, Deklaratë A.M, FDH-15960.

42 TPNJ, Komanda e brigadës së 37-të të motorizuar, 27.03.1999. Raporti i rregullt luftarak (TPNJ, IT-05-87:Milutinovic et al, Exhibit P02045).



dhe një pizgauer dhe afër ishin shumë ushtarë. Ushtarët i kanë rreshtuar përballë tanksit dhe me gjuajtje rafalësh kanë vrarë këta meshkuj: Rustem (1932), Islam (1945), Rrahman (1943), Megjit (1972), Nuhi (1984) dhe Rifat (1949) Miftari; Idriz Sejdiu (1942); Mustafë Hyseni (1946); Murat Topalli (1931); Ahmet (1956), Rexhep (1964), Nazmi (1975), dhe Xhevdet (1967) Osmani; Ramadan Bekaj (1934), Bajram (1932) dhe Kadri Hasanaj (1940); Bashkim Imeraj (1976); Hysni Musa (1963)⁴³. Pushkatimin e kanë mbijetuar katër meshkuj: Valoni trembëdhjetë vjeçar të cilin të plagosur në mesin e të vdekurve pas dy ditëve e kishin gjetur vendasit e fshatit Kllodernicë/Kladernice dhe Runik/Rudnika, Driton Mulaj dhe Ahmet dhe Isa Miftari.

6. Lënda Prokurori kundër M. Milutinovića dhe të tjerët

Prokurorja Carter – pyetje dëshmitarit Diković: Pra, edhe pse njësia e juaj ishte e angazhuar në mënyr direkte në atë rajon (operimi në Drenicë), askush nga UJ nuk ju ka thirrur në përgjegjësi nga asnjë nga këto operime apo të ofroni çfarëdo informacioni për gjetjen e varrezave masive?

Dëshmitari Diković – përgjigje: Jo. Më besoni se nuk e di se për cilat varreza masive jeni duke biseduar. Në asnjë varrezë masive nuk kam hasur, po e përsëris, në asnjë varrezë masive në atë rajon⁴⁴.

7. Pjesëmarrjen e brigadës së 37-të të motorizuar në operacionin „Kamenica“

23

Me datë 30. 04.1999 në kohën nga ora 6.00 deri më 18.00 në hapësirën në mes të maleve të Qyqavicës/Čičavice dhe rrugës Skënderaj/Srbica –Glllogoc/Glogovac, ku gjenden fshatrat Baks, Vërboc/Vrbovac, Dashec/Doševac, Shtuticë/Štutica, Çikatovë e Vjetër/Staro Čikatovo, Qirez/Ćirez, është realizuar aksioni në thyerjen dhe shkatërrimin e “FSHT”. Sipas raportit mbi realizimin e aksionit të cilin e ka nënshkruar komandanti i brigadës së 37-të të motorizuar, koloneli Lubisha Diković, janë vrarë 148 pjesëtarë të “FSHT” dhe zënë robër 172 persona⁴⁵.

Në anën tjetër të dhënat e FDH-së tregojnë se më 30.04.1999 në përndjekjen e fshatarëve shqiptarë nga komunat e Glllogoc/Glogovac dhe Skënderaj/Srbica, pjesëtarë të UJ-së/MPB, në fshatrat e Vërboc/Vrbovac, Dashec/Doševac, Shtuticë/Štutica, Çikatovë e Vjetër/Staro Čikatovo dhe Baks, kanë vrarë së paku 150 civil shqiptar të cilët nuk kanë marrë pjesë në armiqësi (pika 4. dhe 5. Dosja L.D)⁴⁶.

43 Baza e të dhënave të FDH, Deklaratë I.M, FHP-20326.

44 TPNJ, lënda nr. IT-05-87-T, Prokurori kundër Millutinoviçit dhe të tjerëve, transcript i dëshmisë së Lubisha Dikoviçit, 11.12.2007.

45 TPNJ, Komanda e brigadës së 37 të motorizuar, komandant Lubisha Dikoviç, 1.05.1999.Raporti mbi realizimin e aksionit „Kamenica“ (MKSJ, IT-05-87:Milutinovic et al, Exhibit 5D01036).

46 Baza e të dhënave, FDH, deklaratat e 82 dëshmitarëve në periudhën nga viti 1999 deri në vitin 2007.



8. Vendosja e kontrollit në komunitat e Glogoc/Glogovac dhe Skënderaj/Srbica

Me datë 4.05.1999 komandanti i brigadës së 37-të të motorizuar Lubisha Dikoviç e ka njoftuar komandantin e korpusit të Prishtinës që (shqiptarët) banorë civil janë vendosur në kontroll nga ana e njësisë dhe është nënshkruar. Ka raportuar se në Skënderaj/Srbicë gjenden 4.981 banorë civil „nga të cilët 380 të aftë për luftime të cilët janë ndarë dhe mbrojtur fizikisht në SHF“⁴⁷. Në raportin e njëjtë komandanti i brigadës së 37-të të motorizuar thekson se në fshatin Gllobar/Globare kanë mbetur 291 persona civile në fshatin Qirez/Ćirez 230, në fshatin Shtuticë/Štutica 150, në fshatin Çikatovë e Vjetër/Staro Čikatovo rreth 500 gra, fëmijë dhe të moshuar⁴⁷.

Sipas të dhënave të FDH-së më 1.05.1999 pjesëtarët e UJ-së/MPB-së i kanë nxjerrë rreth 130 shqiptarë të rritur nga xhamia e Qirez/Ćirezu, dhe i kanë dërguar në Çikatovë e Vjetër/Staro Čikatovo, ku në grupe i kanë pushkatuar⁴⁸.

Me datë 12.05.1999 përfaqësuesi i Komandës së brigadës të 37-të të motorizuar ishte në fshatin Çikatovë e Vjetër/Staro Čikatovo. Nga shqiptarët që kishin mbetur ka kuptuar se pjesëtarët e UJ-së i kanë vrarë nëntë banorë .

9. Rishqyrtimi i emërimit dhe përgjegjësia e Lubisha Dikoviçit

24

FDH fton presidentin e Republikës së Serbisë që të shikojë në mënyrë të kujdesshme dokumentet ushtarake dhe gjyqësore (TPNJ) të cilat degradojnë dhe shpiejnë në përgjegjësinë personale dhe komanduese të gjeneralit Lubisha Dikoviçit dhe ta anulojë emërimin e tij në detyrën e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë së Republikës së Serbisë.

Dokumentet e TPNJ në formë integrale janë të qasshme në: www.hlc-rdc.org

47 TPNJ, Komanda e brigadës së 37-të të motorizuar, Raport, komandant Lubisha Dikoviç, 4.05.1999 (TPNJ, IT-05-87:Milutinovic et al, Exhibit 5D01080).

48 Baza e të dhënave FDH: deklarata të 68 dëshmitarëve, të dhëna FDH-së në periudhën kohore nga viti 1999 deri në vitin 2007.

